

## DHJETË VJEÇARI I DYTË 1835-1845

### 1. Veshja klerikale - Rregullorja e jetës

Mbasi mora vendimin për të përqafuar jetën klerikale dhe menjëherë provimin e parashikuar po përgatitesha për atë ditë me një rëndësi shumë të madhe, për këtë arsye isha i bindur që zgjedhja e gjendjes së zakonshme varej shpëtimi i përrjetshëm o humbja e përrjetshme. I thashë shumë shokëve të luteshin për mua; kam bërë një nëntëshe në ditën e Shën Mikelit (tetor 1834)<sup>1</sup> i jam drejtur sakramenteve të shenjta, pastaj teologot Cinzano prevosto dhe vikarit .... të vendit tim,<sup>2</sup> më bekoj petkun dhe më veshi si seminarist përpara meshës solemne. Kur më porosi të hiqja veshjen laike me këto fjalë: *“Exuat te Dominus veterem hominem cum actibus suis”*,<sup>3</sup> i thashë zemrës sime: *“Oh sa rrobaa të vjetra kam për të hequr! Zoti im, shkatërro në mua të gjitha zakonet e këqija”*. Kur pastaj më dha koletin shtoi: *“Induat te Dominus novum hominem, qui secundum Deum creatus est in iustitia et sanctitate veritatis!”*,<sup>4</sup> u ndjeva krejt i përmadhur dhe i thashë vetes: *“Po, o Zoti im, bëj që në këtë moment unë të veshi një njeri të ri, pra që nga ky moment unë të rifilloi një jetë të re, e gjitha sipas vullneteve hyjnore dhe që drejtësia e shënjtëria të jenë objekt i qëndrueshëm në mendimet e mia, në fjalët e në punën time. Kështu qoftë. O Marije, të jesh ti shpëtimi im”*.

Kur mbaroi ceremonia në kishë prevosto i im desh të bëjë diçka krejtë profane: të më qonte në festën e Shën Mikelit, që celebruhej në Bardella një katund i Castelnuovo.<sup>5</sup> Ai me atë festë donte më bënte një akt dashamirësie, por nuk ishte diçka e përshtatshme për mua. Unë dukesh si në buratin i veshur me rroba të reja që paraqitej në publik për tu shitur. Përveç kësaj mbas shumë javësh përgatitje për atë ditë të shumëpritur, të gjindesha pastaj në një drekë në mes të njerëzve të çdo shtrese, të çdo gjinie, me grupet që qeshnin, që bënin muhabet, që hanin, që pinin dhe dëfreheshin; njerëz që më të shumtën kërkonin lojra, që kërcenin dhe të ndeshjeve të çdo llojeve; ato njerëz dhe cila shoqëri mund formonte ndonjëherë me një njeri që në mëngjes të së njëjtës ditë kishte veshur rrobat e shënjtërisë, për t’iu dhënë i gjithi Zotit?

Prevosti im i ra në sy dhe duke u kthyer në shtëpi më kërkoi përse në atë ditë të një hareje të përgjithshme, unë të isha treguar i përmbajtur dhe i menduar. Shumë i sinqertë iu përgjigja që krenimi i bërë në mëngjes në kishë nuk përputhej në

<sup>1</sup> Duhej të thuhet: 1835; sipas rregjistrave të famullisë, veshja e Giovanni Boscos u bë të dielen me 25 tetor 1835. Me 24 tetor kremtohej festa e Shën Rafaelit kryeengjell (ajo e Shën Mikelit ishte kremtuar me 29 shtator).

<sup>2</sup> Antonio Pietro Michele Cinzano (1804-1870): i diplomuar në teologji, prevosto i Castelnuovos nga viti 1834 deri në vdekje.

<sup>3</sup> Zoti të zhveshtë nga njeriu i vjetër me veprimet e tij.

<sup>4</sup> Zoti të veshë me njeriun e ri, i krijuar sipas Zotit në drejtësinë dhe në shënjtërinë e vertetë: “...”

<sup>5</sup> Kisha e Bardellas ishte e kushtuar Shën Mikelit Kryeengjell; që kujtohet me 29 shtator. Dukshëm, don Bosco e ngatërron momente të ndryshme: veshja dhe përgatitja, së bashku me prevoston, një banket në Bardella me rastin e festës së pajtorit të Shën Mikelit, ndoshta një vit më vonë.

përgjithësi, ..... me atë të mbremjes. “Biles, shtova, duke parë priftat të bëheshin komikë në mes të ftuarve pranë atyre që ishin të dehur nga vera, gati më kanë bërë të ndjejë neveri për vokacionin tim. Në se ndonjë do të dija se do të bëhesh si një prej këtyre priftave, do të doja më parë të hiqja këtë veshje dhe të jetoja si një laik e varfër, por si një i krishterë i mirë”.

“Bota është e bërë në këtë mënyrë, mu përgjigj prevosto, dhe duhet të marrim siç është. Është e nevojshme të njihet e keqja për ta evituar. Askush nuk bëhet një luftëtar i zoti pa qenë i zoti të përdorë armët. Kështu duhet të bëjmë edhe ne që duhet të luftojmë vazhdimisht kundër armikut të shpirtërave”.

Heshta atëherë, por në zemrës i thashë: “Nuk do të shkoj kurrë më në festat publike, jashtë vetëm në se jam i detyruar për kremtimet fetare”.

Mbas asaj dite unë duhej të kujdesesha për veten. Jeta që deri atë herë kisha bërë duhej të riformohej rrënjësisht. Në vitet përpara nuk kisha qenë një mistrec, por ..... , mendjemadh, i zërë me ndeshje, lojra, kërcime, arkëtime dhe të tjera gjëra të ngjashme që mbushin me gëxim të përkohshëm, por që nuk kënaqnin zemrën.

Për të mbajtur një nivel jete stabile për të mos e harruar, kam shkruar këto pika si zgjidhje:

1° Në të ardhmen nuk do të marr kurrë më pjesë në shfaqjet publike në panairë, në tregjet, as nuk do të shkoj të shoh kërcime o teatër. Dhe për sa të jetë më jetë e mundur nuk do të ndërhyj në drekat, që do të shtrohet në këto raste.

2° Nuk do të bëj kurrë më lojrat e ...., të prestigjatorit, të pelivanit, të shpejtësisë, të litarit; nuk do ti bij më violinës, nuk do të shkoj për gjueti.

Këto gjëra mendoj se janë kundër ..... shpirtit kishtar.

3° Do të dua dhe praktikoj rezervimin, përmbajtjen në të ngrënë dhe në pirë; dhe nuk do të bëj pushim vetëm në orët që janë krejtësisht të nevojshme për shëndetin.

4° Duke qënë se në të kaluarën i kam shëbyer botës me leximet profane, kështu që në të ardhmen do të preukupohem të shërbej Zotit duke u dhën pas leximeve të librave fetar.

5° Do të luftoj me të gjitha forcat e mia çdo gjë, çdo libër, mendim, diskutim, në fjalë dhe vepra që janë kundër virtutit dhe pastëritisë.

6° Përveç praktikave të zakonshme të lutjeve, nuk do të harroj kurrë të bëj çdo ditë pak meditim dhe pak lexime të përsëritshme.

7° Çdo ditë do të mbledh ndonjë shëmbull o ndonjë përfitim të madh nga shpirtërat e të tjerëve. Këtë do ta bëj me shokët, me miqtë, me të afërmit dhe kur të mos mundem me të tjerët, do ti bëj me nënën time.

Këto janë gjëra delikate kur kam veshur petkun klerikal, dhe deri sa të më rrinë mirë ..... të bekuarës Virgjineshë, i kam lexuar më pas një lutje ka formuluar një premtim asaj bamirëse qiellore, ti vëzhgojë me kusht të çfarë do sakrifice.

## **2. Nisja për në seminar**

Me 30 tetor të viti 1835 duhej të gjindesha në seminar.<sup>6</sup> Ato pak tesha ishin gati. Të afërmit e mi ishin të kënaqur, unë më shumë se ato. Vetëm nëna ime ishte në mendime dhe më mbantë sytë të mbyrdhuer në mua sikur donte të më thoshte diçka. Në darkën përpara nisjes ajo më thirri pranë vetes dhe më bërë këtë dikutim.....: “Gjoni im, ti ke veshur petkun e priftit, unë provoj një ngushëllim që një nënë mund të provojë për fatin e birit të saj. Por kujtohu që nuk është pekti që nderon ....., është praktika dhe virtyti. Në ndonjë herë do të dyshosh në vokacionin tënd, ah pash hatrin e Zotit! mos e çndero këtë pekt. .... Do të dua më mirë të kem një katundar të varfër se sa një bir prif që anashkalon detyrat e tij. Kur edhe në jetë të përkushtova të Virgjës së Lume; kur fillove studimet tuaja të kam këshilluar devocionin për këtë Nënë tonë; tashti të këshilloj të jesh krejt i saji: duaji shokët e devotshëm të Marisë dhe në se do të bëhesh prift këshillo e përhap gjithmonë devocionin e Marisë”.

Në përfundim të këtyre fjalëve nëna ime ishte e përmalluar, unë qaja. “Nënë, iu përgjigja, të falenderoj për të gjithë këtë, që keni thenë e bërë për mua; këto fjalët tuaja nuk do të shkojnë kot dhe do të jenë të çmuara për të gjithë jetën time”.

Në mëngjes në kohë shkova në Chieri dhe në mrëmbjen e së njëjtës ditë hyra në seminar. Përsëhëndeta superiorët rregullova shtratin, me shokun Garigliano<sup>7</sup> vendosëm të ecnim nëpër fjetore: pastaj nëpër koridor dhe në fund në oborr. Duke hedhur sytë sipër meridianës lexova këtë frazë: *Afflictis leentae, celeres gaudentibus horae*.<sup>8</sup> “Ja, më thotë shoku, ja programi ynë: të jemi gjithmonë të gëzueshën dhe koha do të kalojë shpejt”.

Ditën që pasoj filloi një .... ushtrimesh<sup>9</sup> dhe u mundova ti bëj mirë për sa më qe e mundur. Kur ato i mbarova shkova tek profesori i filozofisë që në atë kohë ishte teologu Ternavasio di Bra<sup>10</sup> dhe i kërkova disa norma jete me të cilat mund të plotësoja detyrimet e mia dhe të fitoja dashamirësinë e superioreve të mi. “Vetëm një gjë, mu përgjigj prifti i denjë, me përmbushjen e saktë të detyrave tuaja”.

Mora për bazë këtë këshillë dhe u dhashë me gjithë shpirtë për zbatimin e rregullave të seminarit.<sup>11</sup> Nuk bëja dallim kur zilja binte për të na ftuar në studim, në

<sup>6</sup> Me 30 tetor 1835 ishte e premte. Mbi *Calendarium Sanctae Metropolitanae Taurinensis Ecclesiae ad annum 1835*, në ditën e 30 tetorit lexohet: “Hodie vespere Seminaria aperiuntur Taurini et Cherii. Cilleric omnes hic addicti ad sua studia resumend convenient” (Sot, nga darka, hapen Seminarët e Torinos dhe e Chierit. Të gjithë seminaristat të caktuar në këto seminare do të hynë për filluar studimet e tyre).

<sup>7</sup> Guglielmo Garigliano kishte veshur petkun kishtar me 18 tetor 1835, në kishën famullitare të Poirino.

<sup>8</sup> Orët kalojnë ngadalë për kë është i hidhëruar, shpejt për atë që është i lumtur. Ndërtesa e seminarit të Chierit kishte qenë qendër e një Urdhëri të Oratorit të Shën Filippo Neri, nga 1664 deri në 1802, dhe motoja e meridianës i referohej një aspekti karakteristik të përshtetërisë së shenjtë.

<sup>9</sup> Triduo e ushtrimeve ishin të përcaktuara nga Rregullorja: “Hapja e seminarit është e përcaktuar në darkën e 30 tetorit, ditë në të cilën është fillimi i triduo së shenjtë, dhe përfundon në mëngjesin e 3 nëntorit”.

<sup>10</sup> Françesko Ternavasio (1806-1886), i lindur në Bra, i diplomuar në Teologji në Universitetin e Torinos. Përfundoi vitin shkollor 1834-35 në seminarin e Chierit ..... vetën pesëvjeçari i teologjisë. Dy vjeçari i Filozofisë u inaguroi taman në tetor të 1835, me hyrjen e Gjon Boscot. T. Ternavasio qe i pari profesor i filozofisë; qëndroi në Chieri deri në 1837, pastaj u transferua në Bra.

<sup>11</sup> Rregullorja e seminarit të Chierit ishte e aprovuar nga arqipeshkvi mons. Luigj Fransoni në 1832.

kishë, o në mensë, në lirim, në pushim. Kjo saktësi më bëri të fitoj dashurinë e shokëve dhe vlerësimin e superiorëve, shënoi që për mua ato gjashtë vite të seminarit qenë për mua një shtëpi e ngrohtë.

### 3. Jeta e seminarit

Ditët në seminar janë pak a shumë të njëjtat; prandaj unë do të përmendi gjërat duke lënë mundësinë që të përshkuraj veçmas disa nga faktet më të veçanta. Po filloj nga superiorët.<sup>12</sup>

Unë i doja shumë superiorët e mi, edhe ata më kanë dhënë gjithmonë shumë mirësi; por zemra ime nuk ishte e kënaqur. Rektori dhe të tjerët superiorë na ftonin që ti vizitonim kur arrin pushimet dhe kur niseshim për këto të fundit. Kërkush nuk shkonte të fliste me to vetëm në rastet kur do të merrnin ndonjë të bërtitur. Sipas turnit njëri prej superiorëve vinte të bënte asistencë çdo javë në menci dhe në shëtitjet e pastaj çdo gjë përfundonte aty.<sup>13</sup> Sa herë kam dashur të flas, për ti kërkuar ndonjë këshillë o për të zgjidhur ndonjë dyshim, por nuk mundja; biles ndodhte që ndonjë superior duke shëtitur në mes të seminaristëve, pa e ditur arsyen, të gjithë iknin sa djathas sa majtaa si prej një sëmundje. Kjo gjë ndeste më shumë zemrën time për tu bërë shpejt prift për të qëndruar në mes të rinjve, për ti asistuar dhe për ti ndihmuar në çso nevojë.

Përsa i përket shokëve u mbështeta në sugjerimin e nënës së dashur; vlen të thuhet të shoqërohem me shokët që ishin të devotë Maries, të dhënë pas mësimit dhe lutjes. Duhet të them sipas rregullës kush frekuenton seminarin që në të janë shumë seminaristë që shkëqejnë në virtyte, por ka dhe të rrezikshëm. Jo pak të rinj pa u kujdesur për vokacionin e tyre shkojnë në seminar pa pasur as shpirtin, as vullnetin e një seminaristi të mirë. Biles mua më kujtohet të kem dëgjuar bisesa shumë të këqija nga shokët. Dhe një herë, gjatë kontrollit të disa nxënësve, u gjetën libra ..... dhe të pahijshëm të çdo lloji.<sup>14</sup> Është e vërtetë që shokë të ngjashëm o hiqnin vullnetarisht petkun e seminaristit, ose përjashtoheshin nga seminari sapo njiheshin për atë se çfarë ishin. Por për sa kohë banonin në seminar torturonin të mirët dhe të këqijtë.

Për të evituar rrezikun e këtyre bashkënxënësve unë zgjodha disa që ishin shumë të njohur si model virtyti. Ato ishin Garigliano Guglielmo, Giacomelli Giovanni nga

---

<sup>12</sup> Superiorët: kur Gjon Bosco hyri në seminar, superiorët ishin gjashtë: Rektori kanonik Sebastiano Mottura (1795-1876), drejtori shpirtëror Giuseppe Mottura (1798-1876), profesori i teologjisë Lorenzo Prialis (1803-1868) dhe asistenti i tij Innocenzo Arduino (1806-1880), profesori i filozofisë Francesco Ternavasio, don Matteo Testa (1782-1854) rrëfyes dhe rektori i kishës të shën Filippo Neri që ishte e ndërtuar pranë seminarit.

<sup>13</sup> Superiori asistent i turnit quhej *prefekti i rojes*; dhe kishte detyrëë “të asistonte në drekën dhe në darkën e nxënësve; të jepte lejen për dalë nga shtëpia” dhe “të këndoje në meshë në cappella në ditët festive. Kur përfekti i rojes mbaron javën e tij, hynte i njëjti në javën e nënrojes, përsa i përket asistencës të pushimin mbas drekës dhe darkës”.

<sup>14</sup> Inspektimet ishin të kërkuara nga Rregullorja: “.....”

Avigliana<sup>15</sup> e për më tepër Luigji Comollo. Këta tre shokë qenë për mua një thesar i madh.

Praktikat e lutjes kryheshin mjaft mirë. Çdo ditë në meshë, meditim, rruzarja; në menci lexime ..... Në atë kohë lexohej historia kishtarë e Bercastel.<sup>16</sup> Rrëfimi ishte i detyrueshëm një herë në pesëmbëdhjetë ditë, por kush dëshironte mund ta bënte çdo të shtunë.<sup>17</sup> Por kungimi i shenjtë bëhej vetëm të dielën ose në një kremtim të veçantë. Nga ndonjë herë bëhej gjatë javës, por për të bërë kështu ishte e nevojshme të përmbushej një pandëgjësë. Ishte .... të zgjedhës orën e ngërnies së mëngjesit, të shkoje fshehurazi në kishën e vjetër të S. Filipit, të bëjë kungimin dhe pastaj të shkoje tek shokët në momentin që ktheheshin nga studimi o nga shkolla. Kjo thyerje orari ishte e ndaluar,<sup>18</sup> por superiorët jepnin miratimin e heshtur, sepse e dinin dhe nga ndonjë herë shihnin, dhe nuk thonin asgjë kundër. Në këtë mënyrë kam mundur të ndjek mjaft më shumë kungimin e shenjtë, që mund ta quaj me arsye më efikas ushqim i vokacionit tim. Këtij difekti të lutjes që tashti janë marrë masa, kur, për marrëveshje arqipeshkvi Gastaldi<sup>19</sup> qenë të urdhëruar gjërat që bënin të mundur çdo mëngjes ti afroshim kungimit, por vetëm në se ishte i përgatitur.

### [3a.] Dëfrimi dhe pushimi

Argëtimi më i zakonshëm në kohën e lirë ishte loja e njohur e *Bara rotta*.<sup>20</sup> Në fillim mora pjesë me shumë dëshirë, por duke qënë se kjo lojë ishte shumë e ngjashme me të pelivanëve, që kisha hequr dorë apsolutisht, për këtë arsye vendosa të mos e bëj

---

<sup>15</sup> Giovanni Francesco Giacomelli (1820-1901) zëvendës i don Boscos si kapelan në Spitalin e vogël të S. Filomenës, e ndërtuar nga markezja Giulia di Borolo. Nga 1873 shenjtji do ta zgjedh si rrëfyesin e tij.

<sup>16</sup> Antoine Henri BERAULT-BERCASTEL, *Historia e krishërimit*. Leximi gjatë vakteve ishte parashikuar nga Rregullorja.

<sup>17</sup> “Gjithësecili duhet të rrëfëhet paspaku dy herë në muaj dhe do të marri nga rrëfyesi vertetimin e kryerjes së rrëfimit, në të cilin do të jetë të shkruara emri, mbiemri, klasa, muaji dhe dita në cilin është kryer rrëfimi”; “Mbrëmja e të shtunës, e përcaktuar për rrëfimet, do të qëndrojë në dhomën e studimit njëri nga dy përfektëve të kapelës dhe do të shënojë atë që do të kërkojnë të bëjnë rrëfimin; nuk do të lejojë që të shkojnë në të njëjtën moment të gjithëve lejen për të evituar kunfuzion dhe, përpara mbarimit të studimit, do t’ia çojë shënimin rektori”. (Rregullorja e seminarit të Chierit). Nga rregjistra del që seminaristi Gjon Bosco mban një ritëm rrëfimi çdo dy javë në tre vitet e para (1835-1838); në vazhdim do të rrëfëhet çdo javë, me pak përjashtime. Të njëjtët rregjistra na informojnë se gjatë vitit të parë pat dy rrëfyes, don Filippo Navissano (1801-1842) dhe can. Francesco Bagnasacco (1776-1846); por nga nëntori i 1836 zgjedh can. Giuseppe Maloria, rrëfyesi i tij që nga vitet e shkollës publike, dhe ai i qëndron besnik deri në përfundimin e seminarit.

<sup>18</sup> Në Rregulloren e seminarit të Chierit ishte shkruar: “Përsa i përket kungimit gjithësecili do të afrohet sipas përcaktimit të rrëfyesit të tij: ...”

<sup>19</sup> Lorenzo Gastaldi (1815-1883), peshkopi i parë i Saluzzo (1867), pastaj arqipeshkv i Torinos (1871). Përmirësoj rregullat e seminarit dhe i dha më shumë impuls formimit të seminaristëve.

<sup>20</sup> *Bara rotta (o barra rotta)*: lojë skuadre, e bazuar në forcën e refleksëve, mbi shpejtësinë në vrapim dhe në strategjinë e grupit.

më. Në ditë të caktuar ishte e lejuar loja me letra<sup>21</sup> në të cilat kam marrë pjesë për disa kohë. Por edhe këtu gjeta të ëmblën të përzier me të idhtën. Edhe pse nuk isha në lojtar i vlefshëm, megjithatë isha kaq me fat që fitoja pothuajse gjithmonë. Në fund të lojës unë i kisha duart plot me para, por duke parë shokët e mi të trishtuar sepse kishin humbur, unë bëhesha më i trishtuar se ato. Duhet të shtoj që gjatë lojës unë fiksoja krejtë mendjen time që mbrapa unë nuk mundja as të lutesha, as të studioja, duke pasur imagjinatën e trazuar nga *Krajli i Kupës* dhe nga *Fanti Spathi*, nga 13 o nga 15 i letrave. Për këtë arsye kam marrë vendimin që të mos marr më pjesë në këtë lojë siç kisha hequr dorë me të tjerat. Këtë e bëra në mesin e vitit të dytë të filozofisë në 1836.<sup>22</sup>

Pushim mes orëve, kur ishte më i gjatë se zakonisht, ishte e gjallëruar nga ndonjë shëtitje që seminaristat bënin shpesh në vendet .....<sup>23</sup> që rrethonin qytetin e Chierit. Ato shëtitje na bënin mirë edhe në studime, për këtë gjithësecili mendohej të bënte ushtrimet e shkollës, duke pyetur shokun e tij, o duke iu përgjigjur pyetjeve të bëra. Jashtë orareve të shëtitjes, secili muund edhe të bënte shëtitje me shokët në seminar, duke biseduar për gjërat ....., mbështetëse dhe shkencore.

Në pushime<sup>24</sup> e gjata shpesh mblidheshim në mence për të bërë ashtu të quajturit rrethe shkollore.<sup>25</sup> Secili bënte pyetje përreth gjërave që nuk dinte, o që nuk kishte kuptuar nga traktatet o nga shkolla. Kjo që më pëlqente shumë dhe që ishte shumë e dobishme për studimet, për lutjet dhe për shëndetin. I famshëm për të bërë pyetje ishte Comollo që kishte ardhur në seminar një vit mbas meje.<sup>26</sup> Në farë Peritti Domenico,<sup>27</sup> tashti famullitar në Buttigliera, ishte mjaft gojtar dhe përgjigje gjithmonë: Garigliano ishte dëgjues i shkëlqyeshëm. Bëja vetëm ndonjë reflektim. Unë pastaj isha president dhe gjyqtar i pakthyesëm.

Duke qënë se në familjarët tanë diskutimet nxirnin në pah disa çështje, disa pika shkencore, të cilave nga ndonjë herë asnjëri nuk dinte ti jepte përgjigje, kështu ndanim vështirësitë. Gjithësekush brenda një kohë të përcaktuar duhej të përgatiste zgjidhjen për atë që ishte ngarkuar.

---

<sup>21</sup> Në Rregulloren e seminarit të Chierit (kap. VII, n.4) lexohet: “Ndalohet çdo lloj loje me letra, me zare, ..... Loja e letrave mund të lejohet nga Rektori, .....”

<sup>22</sup> Viti i dytë i filozofisë: 1836-1837.

<sup>23</sup> Në Rregulloren e seminarat të Chierit (kap. VI, n. 6) është shkruar: “Të hënë dhe të ejten të çdo jave do të jetë kushtuar shëtitjes. Duke dalë nga seminari seminaristët do të ecin sipas rregullit dy e nga dy, distanca ndërmjet çifteve nuk duhe të jetë më e madhe se tre hapa”. (kap. VII, n.4) lexohet: “Ndalohet çdo lloj loje me letra, me zare, ..... Loja e letrave mund të lejohet nga Rektori, .....”

<sup>24</sup> Pushimet: pushimet e gjata, zgjasnin treçerek ore, dhe bëhesh mbas drekës dhe mbas darkës.

<sup>25</sup> Rrethet shkollore: ishte një veprimtari didaktike e parashikur nga sistemi shkollor i kohës, kishte si qëllim të thelloheshin në lëndën dhe në ushtrimet e dialektike të nxënësve. Zhvillohej pasditeve, përpara shkollë, për gjysëm ore, më në drejtimin e profesorit asistent, i cili ngarkonte një nxënës të mbronte një temë dhe të tjerët ta hidhnin poshtë, ose i diktonte një pyetje që duhej përgjigjur.

<sup>26</sup> Luigji Comollo kishte marrë pektin e seminaristi me 21 tetor 1836 nga xhaxhai Giuseppe, famullitar i Cinzanos.

<sup>27</sup> Domenico Peretti (1816-1893), i lindur në Volvera, në 1850 do të bëhej famullitar i Buttiglieras së Sipërme, vend 26 km nga Torino, pranë Avigliana.

Pushimi im ishte jo rradhë herë i pyetur nga Comollo. Ai më kapte nga një cep i petkut dhe duke më thënë ta shoqëroja duke më drejtuar nga kishëza për të bërë vizitë të Shenjtërueshmit Sakrament për të sëmurët..., të thonim ruzaren o ... e Zojës për të mirë të shpirtrave të purgatorit.

Ky shok i mrekullueshëm qe fati im. Në atë kohë dinte të më vinte në dijeni, të më korigjonte, të më ngushëllonte, por me një sjellje të mirë dhe shumë dashuri që në një farë mënyre isha i kënaqur të jepja ndonjë arsye për të shijuar kënaqësin të isha e korigjuar. Mirresha vesh familjarisht me të, më dëgjonte natyrshëm i gatshëm për ta imituar dhe, edhe pse se isha shumë larg nga ai në virtyte, gjithësesi në se nuk u shkatërrova nga hallakatjet dhe në se do të avancoj në vokacionin tim i jam me të vërtetë atij borxhli. Vetëm në një gjë nuk kam provuar ta imitoj: në sakrifikim. Duke parë një djalë të ri rreth të nëntëmbëdhjetave të agjëronte me shumë rreptësi gjatë të gjithë periudhës së krezhmeve dhe një tjetër kohë të cilin Kisha urdhëronte; të agjërosh çdo të shtune për nder të B.V.; shpesh duke hequr dorë nga e ngëna e mëngjesit; shpesh hante drekën me bukë e ujë; të duronte çfarëdo përçmimi, fyerje pa pasur kurrë as më të voglin inat; duke e parë të përpikët në më të voglën detyrë të studimit dhe të lutjets; këto gjëra më habisnin dhe më bënin<sup>28</sup> të njihja tek ai shok një idhull si mik, një nxitje nga e mira, një model virtyti për të jetuar në seminar.

#### **4. Pushimet**

Një rrezik i madh për seminaristët ishin pushimet, aq më tepër që në atë kohë zgjasnin katër muaj e gjysëm.<sup>29</sup> Unë e zija kohën duke lexuar, duke shkruar, por nuk dija akoma ..... nga ditët e mia humbja shumë pa frut. Mendoja ti kaloja duke bërë ndonjë punë mekanike. Bëja fusi, cavigliotti, trottole, gjyle o fishkë në torno; qepja rroba, i prisja, qepja këpucë; punoja hekurin, drurin. Akoma kam present në shtëpinë time në Morialdo një tavolinë shkrimi, në tavolinë buke me disa karrike që më kujtojnë veprat e mia të atyre pushimeve. Biles merresha dhe me prerjen e barit në livadhe, të korrja drithrat në fushë; a spampinare, a smoccolare, të vilja, a vineggiare, a spillare il vino e simili.

Kisha kujdes për djelmoshat e mi, por këtë mund ta bëja vetëm në ditët e festave. Megjithatë gjeta një ngushëllim duke i bërë katekizëm shumë prej shokëve të mi që gjindeshin në moshën gjashtëmbëdhjetë-shtatëmbëdhjetë vjeçare plotësisht të uritur për të vertetat e fesë. Pata filluar të jap mësim disave në lexim dhe në shkrim me mjaft sukses, ndërsa dëshira madje ...smania për të mësuar tërhiqte të rinj nga të gjitha

<sup>28</sup> .....

<sup>29</sup> Pushimet fillonin me 24 qershor, festa e Shën Gjon Pagëzuesit të cilit i ishte kushtuar katedralja e Torinos, dhe përfundonin me 30 tetor. Gjatë pushime seminaristët i besoheshin kujdesit të famullitarëve respektivë, pranë të cilëve duhej të paraqiteshin në mëngjes për meshën, për uficiet dhe meditimin, pasdite për leximet shpirtërore, bekimin e të Shenjtërueshin Sakrament, lutjen e ruzare dhe pak përsëritje të teologjisë.

moshat. Shkolla ishte falas, por kishte si kusht *këmbënguljen, vemendjen, dhe rrëfimin mujor*. Në fillim disa për të mos pranuar këto kushte e ndërprejnë shkollën. Por pat edhe shembuj të mirë që shërbyen si nxitje për të tjerët.

Kam filluar të bëj predikime e diskutime me lejen dhe ndihmën e provostos tim. Predikova mbi SS. Ruzare në fshatin Alfiano,<sup>30</sup> në pushimet e fizikës;<sup>31</sup> mbi S. Bartolomeun apostull mbas vitit të parë të teologjisë në Castelnuovo në Asti; mbi Lindjen e Marijes në Capriglio.<sup>32</sup> Nuk se cili mund të ketë qenë rezultati. Në të gjitha vendet më kanë duartrokitur, kështu mburrja vazhoi të më drejtojë, deri kur u zhgënjeva si më poshtë. Një ditë mbas predikimit mbi lindje e Marisë pyeta dikë, që më dukej më inteligjenti, përse i përket predikimit, në të cilën lavde sperticati, dhe mu përgjigj: “Predikimi yt që mbi shpirtërat e shkretë të Purgatorit”, dhe unë kisha predikuar mbi lavdinë e Marisë. Në Alfiano pata dëshirë ti kërkoja mendim dhe famullitarit, njeri me shumë mëshirë dhe dije, që quhej Pellato Giuseppe,<sup>33</sup> dhe iu luta të më thoshte mendimin e tij përreth predikimit tim.

- Predikimi juaj, mu përgjigj, që mjaft i bukur, i rregullt, i zhvilluar në një gjuhë të mirë, me mendime tërheqës; dhe duke vazhduar kështu mund t’ia delni në bëni në predikim.

- Populli a ka arritur të kuptojë?

- Pak. Do të kenë kuptuar vëllai prift, unë dhe pak të tjerë.

- Si është e mundur të mos kuptohen gjëra kaq të thjeshta?

- Ju ju duken të thjeshtë, por për popullin janë mjaft të larta. Të prekësh historinë e shenjtë, të fluturosh duke arsyetuar mbi një pëlhurë me ngjarje të historisë kishtare, janë të gjitha gjëra që populli nuk i kupton.

- Çfarë më këshillon të bëj atëherë?

- Braktis gjuhën dhe mënyrën e klasikëve, fol gjuhën e popullit ku të mundesh, o edhe në gjuhën italiane, por popullorshe, popullorshe, popullorshe. Përse i përket gjykimeve, mbaj parasysh shëmbujt, ngashmëritë, në apologji të thjeshta dhe praktike. Por ke parasysh gjithmonë që populli kupton pak dhe që e vërteta e fesë nuk i është spjeguar asnjëherë mjaft.

Kjo këshillë atërore më shërbeu si normë për të gjithë jetën. Ruaj akoma a mio disdoro ato diskutime, në të cilët ..... vetëm mburrjen dhe përpunimin. Zoti i mëshirshëm pat vendosur që ta marr atë mësim, mësim frutdhënës i predikimeve, në katekizëm, në të mësuar e në të shkruar, të cilit që nga ai moment i kam zbatuar.

---

<sup>30</sup> Alfiano Natta: vend që ndodhet 27 km nga Castelnuovo, i diocesisë të Casale; në ato vite kishte 1400 banorë.

<sup>31</sup> Pushime të fizikës: janë atë të vitit 1837, mbas vitit të dytë të filosofisë, e thën fizike (viti i parë quhej i logjikës).

<sup>32</sup> Festa e Zojë Ruzare kremtohej të parë të diele të tetorit; festa e shën Bartolomeot është me 24 gusht dhe festa e Lindje së Marisë kremtohet me 8 shtator.

<sup>33</sup> Giuseppe Pellato (1794-1864), famullitar i Alfianos nga 1823 deri sa vdiq.



## 5. Festa në fshat – Tingulli i vjolinës – Gjuetija

Ndërsa pak përpara thashë se pushimet janë të rrezikshme e pata për veten time. Një seminaris i shkretë pa e kuptuar mund të gjendet në ndonjë rrezik të madh. Unë qeshë një provë. Një vit më patën ftuar në një festë në shtëpinë e disa të afërmve të mi. Nuk doja të shkoja, por ma mushne mendje duke më thënë se nuk kishte asnjë seminaris që shërbente në kishë, ftesave të pandërprera të një xhaxhai tim besova mirë dhe vendosa të bindesha dhe shkova. Mbasi mbaruan kremtimet e shenjta, në të cilat mora pjesë duke shërbyer dhe kënduar, shkuam për drekë. Deri në farë pike të drekës çdo gjë shkoi mirë, por kur filluan të jenë pak sa pijshëm nga vera filluan të flasin turli fjalësh që nuk mund të duroheshin nga një seminarist. Provova të bëj ndonjë vërejtje, por zëri im u mbyt. Duke mos ditur më se nga cila anë të shkoja desha të ikja. U ngrita nga tavolina, mora kapelën për të ikur; por xhaxhai kundërshtoi; një tjetër filloi të fliste më keq dhe të fyente të pranishmit. Nga fjalët u kalua në vepra; të bërtitura, kërcënime, gota, shishe, pjata, lugë, pirun me thika, u bashkoheshin së bashku duke bërë një potere të tmerrshme. Në atë moment unë nuk pata çfarë të bëja veç t'ia mbathja këmbëve. Sa mbërrita në shtëpi kam përsëritur me gjithë zemër propozimin, që e kisha bërë mjaft herë, të rrija i tërhequr në se doja të mos hyja në mëkat.

Një fakti i një lloji tjetër, por eziandio e pakëndëshme më ndodhi në Croveglia<sup>34</sup> një lagje e Buttigliera. Duke dashur të marr pjesë në festën e S. Bartolomeut, më ftoj një tjetër xhaxha i imi që të ndërhyja për të ndihmuar në funksionet e shenjta, të këndoja dhe ti bija violinës që kishte qenë për mua një instrument i preferuar, nga e cila kisha hequr dorë. Çdo gjë në kishë shkoi shumë mirë. Dreka bëhej në shtëpinë e xhaxhait tim që ishte drejtuesi i festës, deri në atë moment asgjë s'kishte të sharë. Mbasi mbaruan atë që kishin para të pranishmit më ftuan ti bija ndonjë ndonjë gjëje për dëfrim. Unë nuk pranova. “Paspaku, tha një muzikant, më shoqëro. Unë po bëj të parën dhe ti bëj pjesën e dytë”.

I mjeri unë! nuk munda ta kundërshoj dhe ti bie violinës dhe i rashë një pjese, kur dëgjohet një mëmëritje dhe një calpestio që shënonte një mori njerëzish. Atëherë dola në dritare dhe pashë një grumbull personash që në oborrin aty afër po kërcenin gëzueshëm nën tingujt e violinës sime. Nuk mundem të shpreh me fjalë zemërimin që mbërtheu në atë moment. “Si, i thashë të pranishëmve, unë që jam kundër shfaqjeve publike, unë të jem nxitësi i saj? Nuk do ta bëj kurrë më”. E bëra copë-copë violinën dhe nuk desha kurrë më ta përdori, megjithëse siansi ..... në kremtimet e shenjta.

Akoma dhe një ngjarje që në ka ndodhur gjatë një gjuetije. Shkoja nga nidiata për gjatë vere, në vjeshtë fishkëlleja me vishtull, me kurtha të vogla, me passeriera dhe ndonjë herë dhe me çifte. Një mëngjes duke ndjekur një lepur dhe ecur nga fusha në fushë, nga vreshti në vresht, kalova livedhe e kodra për shumë orë. Më së fundi arrita ta kem nën drejtim gjuajtje atë kafshë që me një të goditur arrita ti thyej brinjët, e shkreta

<sup>34</sup> Ka dashur të thotë Crivelle, lagje e Buttigliera në Asti 6,5 km nga Castelnuovo. Croveglia në fakt është lagje në komunën e Villanova në Asti.

kafshë u lëshua për dhe duke më lënë në dërmuar duke e parë ashtu të fikej. Drejtë tij vrapuan shokët e mi e ndërsa ato gëzohesin për atë pre, i hodha një sy vetes sime dhe vura re që isha në mëngë të kthyre të këmishës, pa veladon, me një kapele kashte, kështu që dukesha si një sfrosadore; dhe në një vend aq larg shtëpisë sime rreth dy milje.<sup>35</sup>

U ndjeva shumë i turpëruar, i kërkova të falur shokëve me atë skandal që dhashë me atë mënyrë veshje, u ktheva për në shtëpi dhe hoqa dorë përsëri dhe përgjithmonë nga çdo lloj gjoje. Me ndihmën e Zotit këtë herë e mbajta premtimin. Zoti ma faltë atë skandal.

Këto tre fakte më kanë dhënë një mësim të tmerrshëm dhe që nga ajo herë dhe mbrapa u dhashë mbas tërheqjes me më përkushtim, dhe qeshë me të vertetë i bindur që në se duhet të jepsha me çiltërsi shërbimit të Zotit duhej ti linja krejtësisht dëfrimet e botës. Është e vërtetë që shpesh këto gjëra nuk janë mëkate, por është e sigurtë që për bisedat që bëhen, nga stili i veshurit, nga të folurit dhe nga veprimet, përmbajnë gjithmonë ndonjë rrezik për të shkatërruar shpirtin, veçanarisht për pastërtinë këtë virtyt kaq delikat.

### **[5a.] Mardhëniet me Luigji Comollon**

Deri sa Zoti e la në jetë këtë shok të jashtëzakonshëm, pata gjithmonë një marrëdhënie të ngushtë. Gjatë pushimeve mjaft herë shkova tek ai, shpesh herë ai erdhi tek unë. të shpeshita ishin letrat që shkruanim. Unë shihja tek ai një të ri shenjtë; e doja për virtytet e tija të rradha; ai më donte sepse e ndihmoja në studimet e shkollës, dhe pastaj kur isha me të sforcohesha që ta imitoja në çdo gjë.

Gjatë një pushimi erdh tek unë për të kaluar një ditë në kohën që të afërmit e mi ishin në fushë në të vjela. Ai më lexoi një diskutim të tijin që donte ta recitonte në festën e të Ngriturit në qiell të Marisë; biles e recitoi duke e shoqëruar fjalët me gjeste. Ishim vetëm në shtëpi. Çfarë të bënim?

- Altola, në thotë Comollo, unë po ndezi zjarrin, ti pregatit kusinë dhe po bëjnë ndonjë gjë për të ngërnë.

- Shumë mirë, iu përgjigja, por më përpara po shkojmë të marrim një zog pule në oborr dhe kjo do të na shërbejë për të bërë lëng mishi, se këtë kishte ndër mend të bënte dhe nëna ime.

Shpejt arritën ta zëmë zogun e pulës, por pastaj kush do ta vriste? As njëri as tjetri. Për të arritur në një përfundim vendosom që Comollo të mbante shpendin me qafën mbi një trug druri të shtrirë, ndarsa me një drapër pa maje unë do t'ja prisja qafën. Bëra vetëm një goditje, koka uu shkëput nga trupi. Të dy të trembur vrapuam të frikësuar nga sytë këmbët duke qarë.

---

<sup>35</sup> Dy milja: rreth 5 km.

- Sa të marrë që jemi, tha paspak Comollo, Zoti ka thënë ti përdorim kafshët e tokës për të mirën tonë, përse pra e gjitha përbuzje për këtë fakt? Pa vështirësi kemi kapur atë kafshë, pastrua nga puplat e gatuar, na shërben për drekë.

Unë duhej të shkoja në Cinzano për të dëgjuar diskutimin e Comollos mbi të Ngjiturin e Zonjës në Qiell, por duke qënë se edhe unë isha i ngarkuar të bëja diku tjetër për të njëjtën festë një diskutim të tillë, shkova të nesërmen. Ishte një mrekulli të dëgjosh zërat e lavdërimit që ushtonin nga të gjitha anët mbi predikimin e Comollos. Atë ditë me (16 gusht) ishte festa e shën Rrokut,<sup>36</sup> që ndryshe e quajnë festa e pignatta o e kuzhinës, sepse të afërmit dhe miqtë ftojnë të dashurit e tyre për drekë për tu kënaqur me ndonjë shfaqje puplike. Me atë rast ndodhi një ngjarje që tregoi se deri ku mund të arrinte guximi im.

Pritej predikuesi i atij krimtimi pothuajse deri në momenti për të hipur pulpito që nuk erdhi. Për të hequr nga një sikleti prevoston e Cinzanos unë shkoja sa tek njeri sa tek tjetri nga famulltarët e shumtë që kishin ndërhyrë, duke i lutur dhe ngulur këmbë që ndonjëri të drjetojë një predikim popullit të shumtë që mbledhur në kishë. Asnjëri nuk e miratonte. Të mërziur nga kërkesat e mia të përsëritura mu përgjigjen acremente: “Sa budalla<sup>37</sup> që jeni; të bësh një diskutim mbi shën Rrokun të paparashikuar nuk është si të pish një gotë verë; dhe sa rrini duke shqetësuar të tjerët bëjeni ju”. Mbas këtyre fjalëve të gjithë duartrokitën. I turpëruar dhe i vrarë nga krenia ime iu përgjigja: “Sigurisht nuk guxoja të offerirmi për një sipërmarrje kaq të madhe, por duke qenëse të gjithë refuzuan, unë pranoj”. U këndua një lavd i shenjtë në kishë për të më dhënë disa çaste kohë për të menduar; pastaj duke i thirrur kujtesës sime për jetën e shenjtit, që e kisha lexuar, hipa në pulpito, bëra një diskutim që gjithmonë më thanë se ka qenë më i miri ndër ato që e kishin bërë para meje por edhe për ato e bënë pas meje.

Në ato pushime me të njëjtin rast (1838) dola një ditë shetitje<sup>38</sup> me mikun tim mbi një kodër, nga ku dukej një shtrirje e gjërë livadhesh, fushash dhe vreshtash.

- Shih, Luigji, fillova të flas, sa pak të korra kemi këtë vit! Të shkretët fshatar! E gjithë ajo punë pothuajse e shkuar kot!

- Është dora e Zotit, mu përgjigj ai, që peshon mbi ne. Më beso, mëkatet tona janë arsyeja.

- Vitin e ardhshëm shpresoj që Zoti do të na japë fryte më të bollshme.

- Shpresoj edhe unë, do të jetë mirë për atë që jenë për ti shijuar.

- Hajt pra, ti lëmë mendimet melanconike, për këtë vit duhet të bëjmë durim, por vitin e ardhshëm do të kemi një vjelje të bollekshme dhe do të bëjmë një verë më të mirë.

- Ti do ta pish.

<sup>36</sup> Në Cinzano, përveç kishës famullitare kushtuar shën Antonio abat, ekzistonin kapelat e shën Sebastianit, shën Rrokut, shën Deriserios dhe të shën Maria e varreve.

<sup>37</sup> Italianizimi i termit piemontez mincion, budalla; ekziston dhe folja .....

<sup>38</sup> Nga kjo pikë deri në fund të kapitullit, autori kopjon gërmë për gërmë nga libri i tij *Shënime nga jeta e të riut Luigj Comollo vdiq në seminarin e Chierit i admiruar nga të gjithë për vitytet e tij të rradha*, shkruar nga meshtari Gj.Bosco koleg i tij.

- Ndoshta ti doje të thoje të vazhdosh të pish ujin tënd të zakonshëm?

- Unë shpresoj të pij në verë edhe më të mirë.

- Çfarë do të thuash me këtë?

- Lëre, lëre..... Zoti di se çfarë bën.

- Nuk po pyes për këtë, unë pyes se çfarë do të thuash me këto fjalë: *unë shpresoj të pij një verë më të mirë*. Do ndoshta të shkosh në parriz?

- Edhe pse unë nuk jam i bërë për të shkuar në parriz mbas vdekjes sime, megjithatë kam shpres të mëdha, dhe prej disa kohësh ndjej një dëshirë të gjallë të shkoj dhe të shijoj ambrosën e të bekuarve, që më duket e pabesueshme që janë akoma të gjata ditët e jetës sime.

Këto thonte Comollo i gëzuar në fëtyrë në një kohë që kishte shëndet të mirë dhe po përgatitej të kthehej në semianar.

## 6. Një fakt i Comollos

Gjërat më të paharrushme që praprinë dhe shoqëruarn vdekjen e çmueshme të këtij miku të dashur qenë të përshkruara veçmas dhe kush dëshiron mund ti lexojë sipas dëshirës. Këtu nuk dua të harroj një fakt dhe i dha motivin shumë të folurave për të cilat flitet në kujtimet që janë publikuarr. Është kjo në vazhdim. Pritja e miqësisë, konfidenca e palimit që ishte mes meje dhe Comollos, zakonisht flisnim se kur mund të ndodhte në çdo moment, për ndarje tonë që do të vinte nga vdekja. Një ditë mbasi kisha lexuar një pjesë të gjatë nga jeta e Shenjtërve, me të qeshur dhe me seriozitet thamë se do të kishte qenë një ngushëllim, se kush do të prej nesh do të vdiste i pari do të kishte sjellë lajme për gjendjen e tij. Përsëritëm shpesh herë një gjë të tillë dhe bëmë këtë kontratë: “Cili prej nesh do të vdesë i pari, në se Zoti e lejon, do të sjell lajm për shpëtimin e tij shokët që është në jetë”. Unë nuk njihja rëndësinë e një premtimi të tillë, dhe po ju them që qe shumë mendjehetësi, kurrë nuk do të këshilloja kënd për të bërë një gjë të tillë. Megjithatë e bëmë dhe shpesh herë e përsëritëm në mënyrë të veçantë gjatë sëmundjes të fundit të Comollos. Biles fjaltë e tija e tija të fundit dhe shikimi i tij konfirmonin atë që ishte thënë për këtë rast. Shumë shokë ishin për këtë të vetëdijshëm.

Comollo vdiq me 2 prill 1839 dhe mbrëmja e ditës pasuese ishte con gran pompa dërguan në varrim në kishën e shën Filipit.<sup>39</sup> Të vetëdijshmit për këtë premtim ishin në ankth për të parë verifikimin. Unë isha edhe më në ankth, sepse shpresoja në një ngushëllim të vetmisë sime. Në mbremje të asaj dite duke qënë se isha në shtrat në fjetore me rreth 20 seminaristë, unë isha i shqetësuar, i bindur se atë natë do të verifikohet premtimi i bërë. Rreth orës 11.<sup>30</sup> një zhurmë e turbullt dëgjohet nëpër koridore: ngjante si një karrocë e tërhequr nga shumë kuaj që po i afrohej derës së fjetores. Duke u bërë në çdo çast dhe më i zymët dhe një gjëmim bëri të dridhej e gjithë

<sup>39</sup> Që të mund të varroset Comollo në kishën e shën Filipit rektori i Seminarit, Sebastiano Mottura, paraqiti një kërkesë formale pranë autoriteteve qeveritare, ditën e vdekjes: “.....”

fjetorja. Të trëmbër seminaristët hidhen nga shtretërit e tyre për të qëndruar së bashku për ti dhënë zemër njëri tjetrit. Në atë moment, në mes të kësaj gjurme të fuqishme kur u dëgjua zëri i qartë i Comollos që tha tri herë: “Bosco, unë kam shpëtuar”. Të gjithë dëgjuan gjurmën, shumë dëgjuan zërin pa i kuptuar sensin; por disa e dëgjuan si unë, a segno që për shumë kohë kjo ngjarje përsëritej në seminar. Qe hera e parë për sa më kujtohet që kam pasur frikë; frikë e shkuar frikës në atë masë aq sa më zuri një sëmundje e rëndë që më çoi deri në grykë të varri. Nuk jam për ti dhënë të tjerë këshilla të kësaj natyre. Zoti është i gjithëpushtetshëm. Zoti është i mëshirshëm. Aq më tepër që nuk i dëgjon ato marrëveshje, nga ndonjëherë në mishirën e tij të pafund lejon që të realizohen, siç ndodhi një rastin që ju tregova.

## 7. Çmimi – Sakristia – Teologu Giovanni Borel

Në seminar unë kam qënë me shumë fat dhe gjithmonë kam gëzuar dashurinë e shokëve të mi dhe atë të superiorëve të mi. Në provimin e semestrit jepej një çmim prej 60 frangash në çdo nivel atij që kishte vlerësimin më të mirë në studim dhe sjelljen morale. Zoti më të vërtetë më ka bekuar, dhe në gjashtë vitet që kalova në seminar kam qënë i preferua për atë çmim.<sup>40</sup> Në vitin e dytë e teologjisë më bënë sakristan, që ishte një detyrë jo e madhe, për një shenjë i çmuar i dashamirësisë së superioreve, për të cilën merrja dhe 60 franga të tjerë. Kështu që kisha pothuajse një gjysëm pensioni, ndërsa për pjesën tjetër merrej zemërimi don Caffaso.<sup>41</sup> Sakristani duhej të bënte kujdes për pastërtinë e kishës, të sakristisë, të altarit, të mbate në rregull llambat, qirat, të tjera mjeteve dhe objekteve të nevojshme për kultin e shenjtë. Ndodhi në atë vit që pata fatin e mirë të njihja njërin prej shërbëtorëve më të përkushtur të shenjtore që kishte ardhur të drejtonte ushtrimet shpirtërore në seminar. Ai u shfaq në sakristi me pamja gazmore, me fjalë qeshura, por gjithmonë të plotësuara me mendime të moralshme. Kur ndoqa përgatitjen dhe falenderimin në meshë, sjelljen, entuzjazmin në celebrim të meshës, kuptova menjëherë që në të ishte një meshtar i denjë, ishte pikërisht teologu Giovanni Borel i Torinos.<sup>42</sup> Kur pastaj filloi predikimin e tij e se ne admiroj popullaritetin,

---

<sup>40</sup> Në seminarin e Chierit, duke u nisur nga viti 1835-36, ishin dy lloje pensioni, ajo normale prej 27 liresh e 50 cent mujore dhe një “pension i vogël” prej 20 liresh, që bënte një ndryshim për sa i përket trajtimit në mensë (seminari jepte bukë e supë, familja shtonte prodhimin e tyre). Si rezultat nga rregjistrat ekonokë, në vitin 1838-39, nga 122 seminaristë, 58 paguanin “pensionin e vogël”, ndër to ishte Gjon Bosco, Luigji Comollo e Guglielmo Garigliano. Në dy vitet e fundit të seminarit Gjon Bosco kaloi nga një “pension i vogël” në një pension normal.

<sup>41</sup> Kemi gjetur nga Arkivat e Shtetit të Torinos tri kërkesa për ndihëmë për seminaristin Gjon Bosco.....

<sup>42</sup> Nel ms. *Kujtimet* e shkruan gjithmonë *Borrelli (o Borelli)*. Giovanni Battista Borel (1801-1873), torinez, i diplomuar në teologji. Kapelan reale (1831-1841), nga 1829 deri me 1843 qe drejtori shpirtëror i kolegjit të shën Françekut nga Paola. Në 1844 mori dhe drejtimin shpirtëror të rifugios dhe nga 1843 iu kushtua plotësisht detyrës baritoretë veprave të markezës Borolo. Nga një Listë e zotërinjve predikator të triditshit të shenjtë dhe i ushtrimve shpirtërore nxjerrim që teologu Borel, në bashkëpunim me teologun Carlo Borsarelli, predikoi në triditshin në fillim të vitit, nga 30 tetori deri me 3 nëntor 1837, pra jo në fillim të vitit të dytë, por në vitin e parë të teologjisë të Gjon Boscot.

gjallërinë, qartësinë dhe flakën e dashurisë që u shfaqte në të gjitha fjalët, secili përsëriste pa ndërprerje se ai ishte një shenjtë.

Në fakt të gjithë viheshin në rradhë për tu rrëfyer prej tij, të diskutonin për të për vokacionin dhe për të pasur ndonjë kujtim të veçantë. Biles edhe unë desha të këshillohem prej tij për gjërat e shpirtit. Në fund i kërkova ndonjë mjet të sigurtë për të ruajtur shpirtin e vokacioni gjatë vitit e në mënyrë të veçantë në kohën e pushimve, ai më la këto fjalë të paharrueshme: “Me tërheqje dhe me kungim të shpeshtë përsoset dhe ruhet vokacioni dhe formohet një meshtar i vërtetë”.

Ushtrimet shpirtërore të teologut Borel lanë gjurmë në seminar, edhe shumë vite pas përsëriteshin thëniet e shenjta që kishte përpara publikut o që kishte këshilluar privatisht.

## 8. Studimi

Përreth studimeve u mbizotërova nga një gabim që në mua mund të kishte prodhuar në mua pasoja të tmerrshme, në se një fakt fatlum nuk do të ma kishte hequr. I mësuar me librat e klasikëve gjatë të vitit të dytë, i praktikuar nga figura që të tërhiqnin vemendjen të mitologjisë dhe të përrallave të paganëve, nuk gjeja shije për gjërat ascetike. Arrita të bindesha që një gjuhë e mirë dhe një gojtari nuk mund të bashkoheshin me fenë. Të njëjtat vepra të Etërve të shenjtë më ngjanin prodhim i mendjve mjaft të kufizuara, përveç principeve të fesë, që ato praqitnin me forcë dhe qartësi.

Mbi principin e vitit të dytë të filozoficë shkova një ditë ti bëja një vizitë të Shenjtërueshmit Sakrament dhe duke qenë se nuk kisha me vetë as edhe një libër lutjesh fillava të lexoja *de imitatione Christi* nga i cili lexova ndonjë rresht përreth të Shenjtërueshit Sakrament.<sup>43</sup> Duke konsideruar me kujdes madhështinë e mendimeve dhe në mënyrë të qartë dhe në të njëjtën kohë të rregullut dhe elokuent me të cilën paraqiteshin këto të vërteta të mëdha, fillova ti them vetes: “*Autor i atij libri një njeri i ditur*”. Duke vazhduar të tjera dhe të tjera herë të lexoja atë veprë të artë, nuk vonova të kuptoja, që vetëm në një strofë të vogël të tij përmblihte aq shumë doktrinë dhe moral, aq sa nuk kisha gjetur në vëllimet e trashë të klasikëve antikë. Ky është libri të cilit i jam borxhli që ndalova së lexuari leteraturën profane. Prandaj u dhashë pas leximit të Calmet, *Historia dhe Beslidhja e Re*;<sup>44</sup> të Giuseppe Flavio, *Antikiteti judaik; Luftat*

---

<sup>43</sup> *De imitatione Christi*: një veprë fatlume anonime që i përket shek. XIV, e ndarë në katër libra, që i atribuohet abatit venedektin të Lucedio (Vercelli) Giovanni Gersenio o kanonikut hollandez Tommaso nga Kempis; pat një ndikim të madh mbi përshpirtëmërinë krishterë në shekujt që pasuan. Këtu don Bosco i referohet librit të katërt, që i kushtohet contemplimit të misterit të eukaristisë. Kishte dalë dhe një botim torinez pikërisht ato dy muaj: *De imitatione Christi libri quatuor ad usum regiarum scholarum*.

<sup>44</sup> Augustin Calmet (1672-1757), autor benediktin i ditur dhe frutdhënës. Don Bosco me shumë mundësi ka lexuar botimin pjemontez: *Historia e Beslidhjes së Vjetër dhe të Re dhe e Ebrejve*.

*judaike*;<sup>45</sup> pastaj me Monsignor Marchetti, *Arsyetimet mbi Fenë*;<sup>46</sup> pastaj me Froyssinous, Balmes, Zucconi<sup>47</sup> dhe shumë të tjerë shkrimtarë fetarë. Pëlqeva edhe literaturën e Fleury, *Histori Kishtare*,<sup>48</sup> që injoroja essere libro dha evitarsi. Edhe më me frutdhënie kam lexuar veprat e Cavalca, të Passvanti,<sup>49</sup> të Segnerit<sup>50</sup> dhe të gjithë *Historinë e Kishës* nga Henrion.<sup>51</sup>

Ju ndoshta thoni: duke u marrë me lexime të tilla, nuk mundja të prisnja nga traktatet. Nuk qe kështu. Kujtesa ime vazhdonte të më favorizonte, dhe vetëm ta lexoja njëherë dhe spjegimi i traktateve në shkollë më mjaftonte për t'ju përshtatur detyrave të mija. Prandaj në gjitha orët e caktuara për studim, unë mundja të merresha me leximet të ndryshme. Superiorët dinin gjithçka dhe më linin të lirë të vazhdoja.

Një lëndë që e kisha fort për zemër ishte gjuha greke. I kisha marrë mësimet e para në kursin klasik, kisha studiuar gramatikën dhe në vazhdim frazat e para të përdorimit të leksikut. Një rast i mirë mu dha uopo mjaft i favorshëm. Në vitin 1836, duke qenë se në Torino kërcënonte kolera, Jezuisët nisën konviktorët përpara kohe nga kolegji i Carmine për në Montaldo.<sup>52</sup> Ai largim përpara kohe kërkonte dyfishin e personelit të mësuesve sepse i duhej të mbulonin klasat me të jashtëmit, që mësonin në kolegji. Meshtari don Cafasso, që kërkohet për këtë, propozoi për mua një klasë të

---

<sup>45</sup> Giuseppe Falvio [Joseph Ben Matityahu] (37-100), historik politik e ushtarak hebre oservante, por i hapur ndaj helenizimit; i internuar në Romë në vitin 67, gjatë një kryengritje hebraike, pastaj i liru nga perndori Vespasiano, iu kushtua mbledhjes së kujtimeve historike. Antikiteti gjudaik është përmbledhja e historisë së popullit hebre nga fillimi dhe në vitin 66; Lufta gjudaikë ndalet mbi ngjarjet ushtarake të revoltës antiromake e vitit 70.

<sup>46</sup> Giovanni Marchetti (1753-1829), apologist antigalikan dhe antigjansenista, arqipeshkv titullar në Ancira. Titulli i veprës së tij është: *Qëndrimi i familjes mbi historinë e fesë*.

<sup>47</sup> Denis de Froyssinous (1765-1841), peshkop titullar i Ermopolit, vikar gjeneral i Parisit, predikues dhe konferencier; konferencat e tija, të vlerësuara për qartësi dhe cilësi kulturore, qenë publikuar në 4 vëllime me titull: *Défense du Christianisme ou Conférences sur la religion* (1825). Jaime Luciano Balmes (1810-1848), filosof dhe publicist spanjoll; vepra që e bëri të famshëm në të gjithë botën – *El Protestantismo comparado con el Catolicismo en sus relaciones con la civilización europeo* (1842-1844) – që përkthyer në frëngjisht, italisht, gjermanisht dhe anglisht. Sigurisht don Bosco nuk e lexuar gjatë viteve të seminarit, por në vazhdim. *Ferdinando Zucconi* (1647-1732) jezuit; është autor i: *Mësime të shenjta mbi Shkrimet e hyjnore* (5 vëll.) të u botuan shumë herë.

<sup>48</sup> *Claude Fleury* (1640-1723), akademik i Francës, rrëfyes i Luigjit të XV. Vepra e tij *Histoire ecclésiastique*, në 20 vëllime, vepër e vlerësuar nga Voltaire, është konsideruar e para histori sistematike e Kishës, për organizimin e parë, për doktrinën dhe për ritet e saja. Në Tetëqindën mbahej si “galikana” e rëndësishme, pra në favor të një farë pavarësie ndërmjet kishave kombëtare nga kontrolli i ngushtë papnor.

<sup>49</sup> Domenico Cavalca (vdiq në 1342) dhe Iacopo Passavanti (1297-1357), fretën domenikan, autorë të veprave ashetike në gjuhën italiane, shumë të preferuara në shek. XIX për pastërtinë e leteraturës dhe të stilit të tyre.

<sup>50</sup> Paolo Segneri (1624-1694), jezuit, predikator i shkëlqyer dhe autor i përbledhjeve të predikimeve të famshme, lavdeve dhe mësime feje, të konsideruara si kryevepra të retorikës fetare.

<sup>51</sup> Mathieu Richard Auguste Henrion (1805-1862), laik, i diplomuar në drejtësi dhe autor i shumë shkrimeve me karakter historik e apologetik, ndër të cilat *Histoire generale de l'Eglise pendant les XVIIIe et XIX siecles* (1836) dhe një monumentale *Historie generale de l'Eglise depuis la predication des apotres jusqu'au pontificat de Gregoire XVI* në 12 vëllime (1834-1836).

<sup>52</sup> Kolegji i Carmine: ishte një prej insituteve të edukimit superior ndër më të prestigjuzët e Torinos,

greqishtes.<sup>53</sup> Kjo që më shtyu që të merrem seriozisht me këtë gjuhë që të bëhesha i aftë për të dhënë mësim. Aq më tepër gjendesha në të njëjtën shoqëri të një meshtari që quhej Bini, njohës i fortë i greqishtes, nga ai pata shumë përfitim. Vetën në katër muaj arrita të përkthej pothuasje të gjithë Beslidhjen e Re; dy librat e parë të Homerit me mjaft ode të Pindaros dhe të Anacreontes. Ai meshtarë i denjë duke admiruar vullnetin tim të mirë vazhdoi të më ndiqte dhe për katër vitet çdo javë lexoja një krijim në greqisht o ndonjë variant që unë ia postoja, dhe ai rregullisht korigjonte dhe pataj ai ma kthente me korigjimet e duhura. Në këtë mënyrë arrita të përkthej nga greqishtja sikur ti përktheja nga latinishtja.

Pikërisht në këtë kohë unë studioja dhe frëngjishten, dhe parimet e gjuhës hebraike. Këto tri gjuhë, hebraisht, greqisht dhe frëngjisht qenë për mua gjithmonë të parapëlqyera mbas latinishtesh dhe italishtes.

## 9. Urdhëri i shenjtë – Priftëria

Atë vit që vdiq Comollo (1839)<sup>54</sup> merrja tonsurën me katër urdhrat e vegjël në vitin e tretë të teologjisë.<sup>55</sup> mbas atij viti lindi mendimi të tentoj që atë që në ato kohë shumë radhë arrihej: të bëja në kurs gjatë pushimeve. Për këtë qëllim pa bërë shumë lëvizje u paraqita i vetëm tek arqipeshvi Fransoni<sup>56</sup> duke i kërkuar në se a mund të studioja traktatet e vitit të katërt gjatë pushimeve dhe kështu të mund të mbyllja pesëvjeçarin në vitin pasardhës shkollor 1840. Duke dhënë si arsye moshën time të avancuar prej 24 vjeçari.

Ai prelat i shenjtë më priti me shumë mirësi, kontrolloi rezultatin e provimeve të mia të dhëna në seminar, më dha mundësinë duke mu lutur që si kusht të dorëzoja të gjithë traktatet korrespondente të kursit që unë dëshiroja të fitoja. T. Cinzano vikari im foraneo ishte i ngarkuar të ndiqte vullnetin e superiorit. Në dy muaj kam mundur me studim të përfundoja traktatet e përshkruara e për urdhërimin e të katërtës temporal të vjeshtës<sup>57</sup> më pranuan në suddiaconato.<sup>58</sup> Tashti që njoh virtytet që kërkohen për atë hap të rëndësishëm, mbes i bindur se unë nuk isha mjaft i përgatitur; por duke qenë se nuk kisha kush të kujdeset direkt për vokacionin tim, jam këshilluar me Don Cafasson që më

<sup>53</sup> Gjon Bosco që asistent i klasës dhe ndihmës mësues i greqishtes në kështjellën e Montaldos nga 11 korriku deri me 17 tetor 1836, siç rezulton dëshmitëe firmosura nga rektori at Giovanni Battista Dessi.

<sup>54</sup> Luigji Comollo vdiq me 2 prill 1839.

<sup>55</sup> Në të vërtetë Gjon Bosco mori tonsurën dhe katër urdhrat e vegjël në vitin pasardhës, të dielën me 29 mars 1840, në kishën arqipeshvnore.

<sup>56</sup> Luigji Fransoni (1789-1862), arqipeshk i Torinos nga viti 1832; për motive politike, do të larghe në Lion në 1850, por do të vazhdojë të drejtojë diocezen nëpër mjet vikarit gjeneral Giuseppe Zappata.

<sup>57</sup> Tempora: ishin tri ditë agjërimi (mërkure, premte dhe shtunë të së njëjtës javë), të lidhura me fillimin e gjithsecilës stinë të vitit; në një periudhë të tillë, sipas një zakoni të vjetër, jepeshin urdhrat e shenjtë.

<sup>58</sup> Suddiaconato: i pari ndër urdhrat e mëdhenj, që përfshinte premtimin e beqarisë dhe detyrimin e lutjeve të përdishme të oficio. Me reformën liturgjike suddiaconato është ndërprerë. Gjon Bosco e mori suddiaconaton me 19 shtator 1840, në kishën e Zojës së Papërlyer që ishte e lidhur me ndërtesën arqipeshvnore.



pat thënë që të ecja përpara dhe të pushoja mbi fjalën e tij. Në dhjetë ditshin e ushtrime shpirtërore të bëra në shtëpinë e Misionit<sup>59</sup> në Torino kam bërë rrëfimin të përgjithshëm deri sa rrëfyeni im të kishte një ide të qartë për ndërgjegjen time dhe të më jepte këshillat e nevojshme. Dëshiroja të përfundoja studimet e mia, por dridhësia nga mendimi që do të mbetja i lidhur për të tërë jetën, për këtë arsye nuk desha të merrja në vendim përfundimtar vetëm mbasi të kisha pasur bindjen e plotë të rrëfyesit tim.

Nga ai çast e mbrapa kam dhënë maksimumin e impenjimit për të vënë në praktikë këshillën e teologut Borel; me tërheqje dhe me kungim të shpeshtë ruhet dhe perfeksionohet vokacioni. Pas kthimit në seminar qeshë i marrë si shembull nga studentët e vitit të pestë dhe më zgjodhën prefekt,<sup>60</sup> që është detyra më e lartë që i është dhënë një seminaristi.

Në *Sitientes* në vitin 1841 mora diakonatin,<sup>61</sup> në temporën verore duhej të merrja urdhrin e priftit. Por dita me një ankth të vërtetë ishte ajo e daljes përgjithmonë nga seminari. Superiorët më donin dhe më jepni panda shenjë mirësie. Shokët ishin të afeksionuar. Mund të thuhet se unë jetoja për to, ato jetonin për mua. Kush donte të rruante mjekrën o chierica vraponte tek Bosco. Kush kishte nevojë për një kapele prifti, për ta qepur, të arnojë ndonjë rrobë shkonte menjëherë tek Bosco. Për këtë arsye ishte shumë e dhimbshme për mua kjo ndarje, të ndahesha nga një vend ku kisha jetuar për gjashtë vjet; ku mora edukimin, shkencën, shpirtin kishtar dhe çdo shenjë të mirësisë dhe të dashurisë që mund të dëshiroja.

Në ditën e shugurimit tim ishte vigjilja e të Shenjtërueshme Trini,<sup>62</sup> dhe kam celebruar të parën meshën time në kishën e S. Franceskut të Assisit ku kryetar i konferencës ishte Don Cafasso.<sup>63</sup> Në vendlindje u priste me shumë etje, sepse prej shumë vitesh nuk ishte celebruar një meshë nga një meshtar i ri; por preferova ta celebroja në Torino pa zhurmë, dhe atë mund ta quaj dita më e bukur e jetës sime. Në Memento të asaj dite të paharrueshme pata kujdes që t'ja kushtoj të gjithë profesorëve të mi, bamirësve shpirtërorë dhe të tashëm, dhe në mënyrë të veçantë compianto Don Calosso që e kam kujtuar gjithmonë si një bamirës fisnik. Të hënën shkova dhe

---

<sup>59</sup> Shtëpia e Misionit, qendra provinciale e etërve Lazaristë të Torinos. Atyre dioqeza e Torinos i kishte besuar predikimin e ushtrimeve shpirtërore atyre që do të merrnin urdhrin.

<sup>60</sup> Prefekt (i fjetores), detyrë që kishte qëllim asistencën në një klasë shokësh; i besohej seminaristave më të rritur dhe më të besueshëm.

<sup>61</sup> *Sitientes*: e shtundja që paraprin të dielën e Pashkëve (quhet kështu nga hyrja e meshës së ditë: “*Sitientes venite ad aquas, dicit Dominus*”). Gjon Bosco që shuguroi diakonin 27 mars 1841.

<sup>62</sup> Vigjilja e të Shenjtërueshme Trini, ishte e shtune e Tempora mbas Rrëshajve, me 5 qershor 1841. Gjon Bosco që shuguroi meshtar në kishën bashkangjitur të arqipeshvisë, kushtuar Zojës së Papërlyer, “super interstitiis dispensatur”, edhe pse nuk kishin kaluar gjashtë muaj nga diakonati. Në të njëjtin pontifikat që shuguroi 42 presbiterë, 26 diakonë dhe 26 suddiaconë të tjerë.

<sup>63</sup> Gjon Bosco celebroi meshën e tij të parë në altarin e Ëngjellit të Rojes. Në kishën e shën Franceskut të Assisit kishte qendrën Konvikti Kishtar. Kryetar i konferencës : profesori titullar i “Konferenca e teologjisë morale”, kurse të specializuara që zgjasnin tre vjet për aftësimin e meshtarëve të rinj në ushtrimin e detyrës së rrëfimit dhe të drejtimit shpirtëror.

celebrova meshë në kishën e SS. Consolata,<sup>64</sup> për të falënderuar të madhen Virgjinën Mari për të mirat e panumëruar, që i kishte marrë nga Biri Hyjnor Jesus për mua.

Të martën shkova në Chieri dhe celebrava meshë në kishën e shën Domenikut, ku edhe tani jeton profesori im i vjetër P. Giusiana, më priste me një dashuri atërore.

Gjatë asaj meshe ai qau gjatë të gjithë kohës nga përmallimi. E kalova me të gjithë atë ditë që mund ta quaj dita e parajsës.

Të ejten, dita e Korpit të Krishti,<sup>65</sup> plotësova dëshirën e bashkëfshatarëve të me, këndova në meshë dhe bëra quivi procesionin e asaj dite solemne. Prevosti deshi të thërrasë për drekë të afërmit e mi, klerin dhe kryesorët e vendit. Të gjithë morën pjesë në atë gëzim, duke qenë se unë isha shumë i dashur nga vendasit dhe gjithsecili kënaqej nga e gjithë kjo, që do të më kthehej në të mirën time. Mbrëmjen e asaj dite shkova në familjen time. Por kur iu afrova shtëpisë që vështrova atë vend të ëndrrës që pata bërë në moshën nëntë vjeçare nuk munda ti ndal lotët e mi dhe thashë: “Sa të mrekullueshme janë planet e Provanisë Hyjnore! Zoti hoqi nga toka një djalosh të mjerë për ta vendosur me të parët e pullit të vet”.

## **10. Principet e detyrës së shenjtë – Diskutimi në Lavriano dhe i Giovanni Brina**

Në atë vit (1841) nga mungesa e prevosto i vicecurato unë mbusha ufficio për pesë muaj.<sup>66</sup> Provoja kënaqësinë më të madhe duke punuar. Predikoj çdo të diele, vizitoja të sëmuret, i ndaja atyre sakramentet e shenjta, duke përjashtuar pendesën, sepse akoma nuk kisha dhënë provimin e rrëfimit. Merrja pjesë në varrime, mbaja sipas rregullit librat e famullisë, bëja certifikatat e varfërisë ose dhe gjëra të tjera. Por kënaqësia më e madhe për mua ishte ti bëja katekizëm fëmijëve, duke qëndruar me to, duke folur me to. Nga Morialdo vinin shpesh e më vizitonin; kur shkoja në shtëpi isha gjithmonë përreth tyre. Në fshat pastaj fillua bile të bëj shokë edhe miq. Duke nga dalë nga shtëpia famullitare isha gjithmonë i shoqëruar nga një varg fëmijësh dhe gjithkund ku shkoja, isha gjithmonë i rrethuar nga miqtë e mi të vegjël që gëzoheshin.

Duke pasur shumë thjeshtësi që të paraqisja fjalën e Zotit shpesh isha i kërkuar për të predikuar, të bëja lëvdata në fshatrat fqinje. Më ftuan të predikoj në S. Benigno në Lavriano<sup>67</sup> nga fundi i muajit tetor të atij viti. E pëlqeva me dëshirë, duke qenë se

---

<sup>64</sup> Kisha e SS. Consolata, është një shenjtore shumë e dashur për torinezët, i kushtohet të Shenjtërueshmes Virgjinës Ngushëlluese. E ndërtuar mbi strukturë bazilike të shek. V, gjatë kohrave ka pësuar ristrukturime të ndryshme. Nga 1834 e 1835 shënjtorja u officiato dagli Oblati di Maria Vergine,

<sup>65</sup> Korpi i Krishtit ka qenë me 10 qershor 1842.

<sup>66</sup> Pesë muaj: nga qershori në fund të tetorit 1842.

<sup>67</sup> Lavriano [Lauriano]: komunë agrikulture dhe tregtare, 24 km nga Castelnuovo, nga mandamenti i Casalborgone, krahinë e diocezës së Torinos (33 km larg), në rrugën për në Casal Monferrato. Në 1841 kishte 1066 banorë. Famullia ishte e kushtuar Assunta, por “solemniteti kryesor I komunës është

ishe dhe vendi i mikut dhe kolegut tim Don Grassino Giovanni,<sup>68</sup> tashti famullia e Scalenghe. Doja ti bëja sa më shumë ndere ati solemniteti dhe për këtë arsye u përgatita dhe shkrova diskutimin tim në gjuhën popullore për të pastër; e studiova mirë, i bindur që do fitoja lavdi. Por Zoti donte ti jepte një mësim të tmerrshëm mburrjes sime. Duke qenë se ishte ditë feste, dhe përpara se të nisesha duhej të celebroja meshën e shenjtë comodota të popullatës, mu desh të merrja një kalë për të shkuar në kohën e duhur për predikim. Mbas bëra gjysmën e rrugës me trok e me galop, kisha arritur në fushën e Casalborgone ndërmjet Cinzanos dhe Berzanos,<sup>69</sup> kur nga një fushë e mbjellë me mel papritmas fluturuan një mori trumcakësh, nga fluturimi dhe zhurma kali im aq u tremb sa mori rrugën, livadhe e fusha. U mbajta pak për shalë, por duke vërejtur që po rrëshqiste nën bark të kalit, u mundova të bëja një lëvizje kalërimi, por shala jashtë vendi më dha të shtyrën lart dhe unë rashë mbi një grumbull gurësh të thyer.

Një njeri që ndodhej në kodrën aty afër duke parë me keq ardhje atë që ndodhi vrapoi me një punëtorin tij të më jepte ndihmë dhe duke më gjetur pa ndenja, më çoi në shtëpinë e tij dhe më sistemoi në më të mirin shtat që kishte. Më kuroi me bujari dhe me shumë dashamirësi, mbas një ore kur erdha në vete dhe kuptova që jam në shtëpi të tjerë kujt. “Mos u shqetësoni, më tha miku, mos u shqetësoni pse jeni të shtëpi të dikujt tjetër. Këtu nuk do t’ju mungojë asgjë. Kam qarur dikë të thërrasë mjekun; dhe një tjetër për të gjetur kalin. Unë jam një fshatar, por jam kujdesur për atë që kishit nevojë. A ndiheni keq?”.

- Zoti do t’jua shpërblejë për gjithë këtë mirësi, o mik i mirë. Besoj se nuk jam shumë keq; ndoshta kam dëmtuar pak shpatullën, që nuk mund ta luaj. Ku ndodhem?

- Ju jeni në kodrën e Berzanos në shtëpi të Giovanni Calosso i mbiquajturi *Brina*, shërbëtori yt i përvuajtur. Unë kam shëtitur botë dhe unë kam pasur nevojë për të tjerët. Oh sa gjëra më kanë ndodhur nëpër panairë dhe tregje!

- Deri sa të vijë mjeku më trego ndonjë gjë.

- Oh sa kam për të treguar edhe unë; dëgjoje njëherë. Shumë vite më përpara në një periudhë vjeshte kisha shkuar në Asti me gomarin time për të blerë të nevojshmen për dimër. Në kthim, kur mbërritëm në fushat e Morialdos kafsha ime e shkretëtë, i ngarkuar sa s’ka më, ra në një moçal dhe mbet e palëvizur në mes të rrugës. Çdo mund për ta çuar që i kotë. Ishte mesnatë, një kohë e errët dhe me shi. Duke mos ditur se çfarë të bëj më fillova të thërras duke kërkuar ndihmë. Mbas disa minutash më përgjigjet dikush nga një shtëpi aty afër. Erdhi në seminarist, një vëlla i tiji me burra të tjerë me pishtarë të ndezur. Më ndihmua të shkarkoj gomarin, e nxorën nga balta, dhe më dërguan mua me të gjitha gjërat e mia në shtëpinë e tyre. Isha gjysmë i vdekur; çdo gjë ishte i ngjyer me

---

kremtimi në nder të S. Benigno të dielen e katërt të tetorit me pjesmarren e banorëve dhe prej zona përreth”.

<sup>68</sup> Giovanni Grassino (1821-1902), bashkënxënës i don Boscòs në seminarin e Chierit dhe në Konviktin Kishtar. Don Grassino bashkëpunoi për disa kohë në Oratorin e Valdokut dhe në atë të Ëngjëllit Mbrojtës; qe drejtor i seminarit të vogël të Giavenos, kur ky iu besuar përgjegjësisë së don Boscòs (1860-1862). *Scalenghe* është një vend në diocezen e Torinos 30 km larg Torinos.

<sup>69</sup> Berzano S. Pjetri ndodhet 8 km nga Castelnuovë: Casalborgone ndodhet edhe 6 km më larg.

baltë. Më pastruan, më shtruan të ha një darkë të mrekullueshme, pastaj më sistemuan në dyshek të butë. Në mëngjes përpara se të nisesha desha ti shpërbleja siç e meritonin; seminaristi ricuso të gjithë duke më thënë: “Nuk mund të thuash se nesër ne kemi nevojë për ju?”.

Kur dëgjova ato fjalë u përmallova dhe tjetri i vuri re lotët e mi.

- Ndiheh keq, më tha.

- Jo, iu përgjigja; më pëlqeu shumë ky tregim, sa që u përmallova.

- Ta dija të bëja diçka për këtë familje!..... Çfarë njerëzish të mirë!

- Si quhej?

- Familja Bosco, ndryshe Boschetti. Por përse po përmallohesh kaq shumë? Ndoshta e njeh këtë familje.... Jeton, a është mirë ai seminarist?

- Ai seminarist, o miku im i mirë, është ky meshtar që je duke e shpërblyer një mirë më shumë se sa ka bërë ai për ty. Është ai vetë që ju sollët në shtëpinë tuaj, që sistemuat në këtë shtat. Profania hyjnore ka dashur që të njihemi me këtë fakt që çfarë të bësh, prit.

Nuk mund të imagjinoni habinë, kënaqësinë e një krishteri të mirë për mua, që në fatkeqësi Zoti më bëri të kuptoj nëpër mjet këtij miku. E shoqja, e motra, dhe të tjerë të afërm dhe miq u gëzuan shumë kur morën vesh se kush isha unë, për të cilin kishin dëgjuar të flitej kaq herë. Non ci fu riguardo che non mi fosse usato. Kur erdhi mjeku, pa që nuk kisha thyerje, e për këtë arsye mbas pak ditësh kur të gjendje kali mund të kthehesha në shtëpinë time. Giovanni Brina më shoqëroi deri në shtëpinë time, dhe deri sa ai jetoi kemi ruajtur gjithmonë kujtimet më të mirë për këtë miqësi.

Mbas kësaj që ndodhi kam qëndruar fort në bindjen për të ardhmen në përgatitjen e diskutimeve të mia që çdo gjë ta bëj për më të madhe lavdi të Zotit, dhe jo për tu dukur i ditur o i mësuar.

## **11. Konvikti kishtar i Shën Fraçeskut të Asisit**

Gati në fund të atyre pushimeve më ishin ofruar tre punë, nga të cilat duhet të zgjidhja: zyra e mësuesit në shtëpinë e zotërie gjenovez me një rrogë prej një mijë fragash në vit; kapelan në Morialdo, ku ato njerëz të mirë, veç për dëshirën për të më pasur aty dyfishuan rrogën e kapelanëve të mëparshëm; të zëvendëskurato në vendin e lindjes. Përpara se të merrja një vendim përfundimtar pata dëshirë të bëj një shëtitje në Torino për marrë një këshillë nga D. Cafasso, që prej shumë vitesh ishte për mua drejtuesi si për gjërat shpirtërore ashtu edhe atë të kohës. Ai mesharë i shenjtë i dëgjoi të gjitha, ofertat e rrogave të mira, këmbëngulje e të afërmeve dhe miqve, detyrën time për të punuar. Pa hezituat asnjë grimë mi drejtoj këto fjalë: “Ju keni nevojë të studioni moralin dhe predikimin. Hiqni dorë tani për tani çdo propozim që ju vjen dhe ejani në

Konvikti”.<sup>70</sup> Ndoqa me kënaqësi këshillën e urtë dhe me 3 nëntor 1841 hyra në mentovato Konvikt.

Konvikti kishtar mund të quhet një plotësim i studimit të teologjik, për këtë arsye në seminarët tona studiohej vetë dommatica, medituese. Moralën studiohet vetëm në bazë të debatit. Këtu mësohet të bëhesh meshtar. Meditimi, leximi, dy konferenca në ditë, mësimi, predikimi, jetë e tërhequr, çdo rahat për të studiuar, libra të autorëve të mirë, ishin gjërat përreth gjithsecili duhet të përkushtohet kujdesit të tij. Dy njerëz të famshëm të asaj kohe ishin në kryet të atij institut shumë të dobishëm: teologu Luigji Guala dhe D. Giuseppe Cafasso. T. Guala ishte themelues i veprës. Njeri i veçantë, i pasur me shkencë, me maturi dhe me guxim, ishte i përgatitur plotësisht në kohën e qeverisjes së Napoleonit I. Në mënyrë që pastaj të rinjtë levit, mbarojnë kurset në seminar, mund të mësonin jetën përkthet të shërbimit të shenjtë, themeloi në seminar të vogël të mrekullueshëm, ana i cili kisha ka shumë të mira në mënyrë të veçantë të shkollës disa rrënjë di giansenismo që edhe tani ruhen ndër ne.<sup>71</sup>

Ndër të tjera çështje shqetësuese ishte probabilitizmi i probabilitizmit.<sup>72</sup> Në krye të të parëve ishte Alasia,<sup>73</sup> Antoine<sup>74</sup> me të tjerë autorë të rreptë praktika e të cilës mund të drejtorë në giansenismo. Probabilisti do të ndjekin doktrinën e shën Alfosit,<sup>75</sup> që tashti është shpallur doktor i Kishës së Shenjtë dhe si autoriteti mund të thuhet teologjia e Papës, sepse Kisha shpalli veprat e saja që të mund të jenë mësim, të predikojë, të praktikojë, nuk i shërbyen gjërat që merituan censurë. T. Guala qëndroi i tundur në mes të dy palëve, dhe në qendër të çdo opinionit vendosi dashurinë në N.S.G.C. Zotin Tonë Jezu Krishtin arriti të afrojë ato ekstreme. Gjërat arritën në një pikë të tillë që merce’ i T. Gualës së shën Alfonsit bëhet mjeshtër i shkollave tona me një avantazh që për shumë kohë e dëshiroam, dhe që sot për sot ndihen efektet e shëndetshme.

---

<sup>70</sup> Konvikti kishtar ishte një institucion për kualifikim baritor dhe formimin shpirtëror të meshtarëve të ri. Drejtohej nga teologu Luigji Guala (1775-1848), që e kishte themeluar në 1817. Shën Giuseppe Cafasso kishte hyrë si nxënës në 1834, zgjidhet nga Guala si “ripetitore” i teologjisë morele dhe bashkëpunëtor; bëhet rektor i Konviktit në 1848.

<sup>71</sup> Giansenismo: rrymë mendimi teologjik lindur në Francë, në shek. XVII,

<sup>72</sup> Probabiliorismo e probabilitizmo: shkolla teologjike morale të zhvilluara nga shek. XVII dhe XVIII, njëra e më e ashpër, tjetra më e moderuar. E para pohonte se, ndërmjet dy situatave o opinioneve – njëra në favor të lirisë dhe tjetra në favor të ligjit – duhej të zgjidhej ajo në favor të lirisë, vetëm në rastin në se është o mund të jetë e konsideruar më e mundshme se ajo më afër ligjit. Ndërsa, probabilitizmi, e thjeshtëson në mënyrë që të pranohen ligjet morale dhe mbështet liceita’ për të ndjekur mendimet në favor të lirisë, edhe pse seriozisht të mundëshme.

<sup>73</sup> Giuseppe Antonio Alasia (1731-1812), profesor i teologjisë morale në Universitetin e Torinos, botoi një traktat të fuqishëm, i përdorur në universitet dhe në seminarët torineze gjatë të gjithë periudhës së Tetëqindës, që u përshtat edhe për Konviktin kishtar.

<sup>74</sup> Paul Gabriel Antoine (1678-1787), teolog jezuit, autor i një *Theologia universa speculativa et dogmatica* (1723) dhe të *Theologia moralis universa* (1726) nga e cila u bënë botime të shumta në Europë në mes të Shtatëqindës dhe fillimet e Tetëqindës.

<sup>75</sup> Shën Alfons Maria de Liguore (1696-1787), avokat i shkëqyer napoletan që braktisi karrierën ligjore për t’iu kushtuar ungjillëzimit të popullit; u bë meshtar në 1726 dhe themeloi Kongregatën e Redentoristëve (1749). Në 1762 u shugurua ipeshkëv i Shën Agata dei Goti. Qe shkrimtar pjellor i teologjisë dhe i literaturës shpirtërore.

Krahu i fortë i Gualës ishte don Cafasso. Me virtytin e tij që i rezistonte të gjitha provave, me një qetësi të habitshme, me një mendjemprehtësi, me maturi mundi të largonte atë ashpërsi që në disa akoma ishte nga probabilitë të kundrejtë liguoristëve.

Në minierë e artë fshihej në meshtarin torinez T. Golzio Felice,<sup>76</sup> edhe ai konviktor. Në jetën e tij modeste bëri pak gjurmë; por me punën e tij të palodhur, me përvujtërinë e tij, dhe me dijet e tija ishte një mbështetje e vertetë ose më mirë të thuhet një krah i fortë i Gualës dhe i Cafassos. Burgjet, spitalet, pulpilot, institutet e bamirësisë, të sëmuret ndër shtëpia; qytetet, vendet e mund të themi dhe pallatet e të mëdhenjve dhe kasollet e të varfërve provuan e rezultate e shendetëshme të përkushtimit të këtyre tre njerëzve të ndritshëm të klerit torinez.

Këto ishin modele që Provania hyjnore më vinte përpara, dhe varej vetëm nga unë për të ndjekur gjurmët, doktrinën, virtytet. Don Cafasso, që prej gjashtë vitesh ishte udhëheqësi im, që zgjedhur drejtuesi im shpirtëror, dhe në kam bërë diçka të mirë i kam nga ai klerik i denjë që në duart e tija kaloi çdo vendim që mora, çdo studim, çdo veprim i jetës sime. Gjëja e parë ai më shoqëroi nëpër burgje,<sup>77</sup> ku mësova fort të njoh sa e madhe është ligësia dhe mjerimi i njerëzve. Të shihje grumbuj të rinjsh, nga mosha 12 deri 18 vjeç; të gjithë të shëndetshëm, të fortë, të zgjuar; por ti shihje aty të plogësht, të brejtur nga insektet, stentar pa bukën shpirtërore e temporale, që gjëja që më bëri të tronditem thellë. Fyerja e atdheut, çnderimi i familjes, poshtërimi i vetes ishin mishëruar në ato të mjerë. Por habija ime më e madhe kur vura re që shumë prej tyre dilnin të vendosur për një jetë më të mirë por ndërkohë ktheheshin shpejt në një dëmin të gjatë, edhe në se kishin dalë prej pak ditësh.

Me këtë rast vura re se si shumë prej tyre ktheheshin në atë vend sepse ishin të braktisur a se stessi. “Kush e di, i thoja vetes, në se këto të rinj do të kishin jashtë një mik, që të kishte kujdes për to, që të kujdesej dhe ti mësonte në fe në ditët e festave, kush e di ndoshta do të qëndronin larg nga shkatërrimi o pas paku të ulej numri i atyre, që kthehen në burgje?”. I thashë këtë mendim don Cafassos, dhe me këshillën e tij dhe me ndriçimin e tij fillova të studioj mënyrën se çfarë i çon për të braktisur frytet e hireve të Zotit pa të cilat janë të kota përpjekjet e njerëzve.

## 12. Festa e Zonjës së Papërlyer dhe pikënisja e Oratorit festiv

<sup>76</sup> Felice Golzio (1808-1873), profesori i parë i Konviktit Kishtar, pastaj rektori i Shënjtore kushtuar Zojës Consolata; ka qenë rrëfyesi i don Boscos mbas vdekjes së don Cafassos (23 qershor 1860).

<sup>77</sup> Insitutet burgje të Torinos ishin pesë: “burgjet e gjykatës së apelit, burgjet korreccionale, atë të vikariatit të vjetër dhe ai i komandës ushtarake, tani në shërbim të kuesturës, për burrat, dhe burgu i detyrueshëm për gratë. Të parët bëjnë pjesë në pallatin e gjyqtarëve suprem, të dytat ndodhen në kuvendin e jezuitëve, të tretët në pallatin e vjetër të kullave [Kullat palatine], të katërtat në kështjellë, ndryshe në pallatin Madama Mbretërore, e fundit në një shtëpi afër lagjeve ushtarake në porta Susa”. Don Cafasso frekuentonte burgje të ndryshme të qytetit për katekizëm, administronte sakramendet dhe shërbimet e veçanta për të vdekurit. Ishte i njohur mbi të gjitha për karizmin e tij për të denuarit me vdekje.

Sapo hyra në Konviktin e shën Françeskut, menjëherë gjeta një grup të rinjsh që më ndiqnin nëpër fusha, nëpër pjaca dhe në sakristinë e kishës së Institutit. Por nuk mund të kisha kujdes të drejt për drejtë për to për mungesë vendi. Një lepido ngjarje më dha mundësinë të tentoj të zbatoj projektin në favor të të rinjve që silleshin nëpër rrugët e qytetit në mënyrë të veçantë të atyre që kishin dalë nga burgu.<sup>78</sup>

Ditën e krenimit të Zojës së Papërlyer (8 dhjetor 1841) në orën e caktuar kisha filluar të vesh pektat e shejtë për të celebruar meshë e shejtë. Ndhimësi i sakristisë, Giuseppe Comotti, duke parë një djalë në një qoshe e fton të shërbejë në meshë. “Nuk di, u përgjigj krejt i turpëruar.”

- Eja, përsëriti tjetri, dëshiroj që ti të shërbesh në meshë.

- Nuk di, përsëri i riu, nuk kam shërbyer kurrë.

- Kafshë je, i tha ndhimësi i sakristisë i zëmëruar, në se nuk di të shërbesh meshë, për çfarë vjen këtu?

Duke thënë këto fjalë i dha krah thuprës së pluhurave, dhe goditi mbi shpatulla o në kokë atë të shkretë. Ndërsa tjetri ia sa mundi këmbëve.

- Ç’ bëre, bërtita me zë të lartë, përse godit mbi të në këtë mënyrë, çfarë të bëri?

- Përse vjen në sakristi, përderisa nuk di të shërbejë në meshë?

- Por ju e dëmtuat.

- E ju çfarë ju duhet?

- Më duhet shumë, është një mik i imi, thirreni menjëherë, kam nevojë të flas me të.

- Katundar, katundar,<sup>79</sup> filloi ta thërriste; dhe duke vrapuar pas tij, duke u siguruar se po sillej mirë, ma afrojo afër.

Tjetri mu afrua duke u dridhur dhe me lot në sy për shkopin që kishte hëngër.

- A ke parë meshë sot? I thashë me dashamirësinë<sup>80</sup> më madhe që munda.

- Jo, mu përgjigj tjetri.

- Eja atëherë e shikoje; pastaj kam dëshirë të flas për një punë, që do të pëlqejë.

Ma premtoi. Ishte dëshira ime t’ia lehtësoj vuajtjet atij të shkreti dhe të mos e lija me përshtypje të këqija karshi drejtuesve të asaj sakristie. Mbas celebrimit të meshës shenjte dhe mbas bërjes së falënderimeve e ftova kandidatin tim në një coretto. Me fytyrë të gëzuar dhe duke e siguruar, që të mos kishte më frikë nga shkopi, fillova ta pyes kështu:

- Shoku im i mirë, si të quajnë?

<sup>78</sup> Djemtë që silleshin: në ato vite, arsyeja e rritje demografike dhe e krizës bujqësore, u verifikua një rritje e migrazionit të rinjve nga fusha në qytet. Të braktisur, të mbledhur në grupe, të shtyrë nga nevoja dhe uria, binin lehtësisht pre e veseve. Të arrestuar nga policia qytetare, mbydheshin në burgjet e Kullave në pritje të gjyqit.

<sup>79</sup> Term dialektor.....

<sup>80</sup> Dashamirësia: njëra nga tre fjalët-çelës të përdorura nga don Bosco për të shprehur tre themelet e sistemit të tij edukativ: “Ky sistem mbështet i gjithi mbi arsyen, fenë, e mbi të gjitha dashamirësinë”. Tregimi në vazhdim paraqet se çfarë ai kupton me një term të tillë: një lidhje njerëzore e kujdesshme ndaj të riut, sinqerisht e përzemërt e dashamirëse, e frymëzuar nga dashuria e krishterë, që shtyn edukatorin ti afrohet për ta kuptuar dhe të marrë përsipër nevojat dhe problemet e tija.

- Quhem Bartolomeo Garelli.
- Prej nga je?
- Nga Asti.
- Babai yt jeton?
- Jo, babai më ka vdekur.
- Po nënë?
- Edhe nëna më ka vdekur.
- Sa vjeç je?
- I kam të gjashtëmbëdhjetat.
- A di të shkruash dhe të lexosh?
- Nuk di asgjë.
- A e ke marrë kungimin shenjtë?
- Nuk guxoj.
- Përse?

- Sepse shokët e mi më të vegjël dinë katekizëm; dhe kaq i madh nuk di asgjë; për këtë ndjej turp po të shkoj në klasat e tyre.

- Në se të bëj katekizëm veçmas, a do të vije të dëgjoje?
- Do të vija me shumë qejf.
- Do të vija me dëshirë në këtë dhomë?
- Do të vija me shumë qejf, vetëm të mos më bien me shkop.

- Rri i qetë, askush nuk do të keqtrajtojë. Biles ti do të jesh miku im, dhe do kesh të bësh me mua dhe me askënd tjetër. Kur dëshiron që ta fillojmë katekizmin tonë?

- Kur të ju pëlqejë juve.
- Sonte?
- Po.
- Dëshiron edhe tani?
- Po dhe tani me shumë kënaqësi.

U ngrita në këmbë dhe bëra shënjen e Kryqit për të filluar, por nxënësi im nuk e bëri sepse nuk njihte mënyrën për ta bërë. Në këtë orë të parë të katekizmit u ndala tek mënyra e të bërit të shenjës së Kryqit dhe ta bëja të njihte Zotin krijues dhe në fund për çfarë na ka krijuar. Edhe pse me memorie të ngadaltë, por me këmbëngulje dhe pak vëmendje në pak ditë arriti të mësonte gjërat më të nevojshme për të bërë një rrëfim të mirë dhe pas pak edhe kungimin shenjtë.

Këtij nxënësi të parë iu shtuan dhe disa të tjerë dhe gjatë atij dimri u kufizova me disa të rritur që kishin nevojë për katekizëm special dhe mbi të gjitha për ato që dilnin nga burgjet.

Qe atëherë që unë preka me dorë që të rinjtë e dalë nga vendet e dënimit, në se gjejnë një dorë dashamirëse që për ta ka kujdes, që merret me to në ditët e festave, të mësojnë dhe ti gjejnë ndonjë vend pune pranë ndonjë padroni të ndershëm dhe ti bëhet ndonjë vizitë gjatë javës, këto të ri bëjnë një të ndershme, harrojnë të kaluarën, bëheshin



të krishterë të mirë dhe qytetarë të ndershëm. Ky është fillimi i Oratorit tonë, që i bekuar nga Zoti mori atë shtrim, që sigurisht nuk mund ta imagjinoja atëherë.

### 13. Oratori i vitit 1842

Prandaj gjatë atij dimri kam punuar të forcoj Oratorin e vogël. Edhe se qëllimi im ishte të mblidhja vetëm djemtë me të pasigurt, të rrezikshëm, dhe preferoja atë të dalë nga burgjet; megjithatë për të pasur një themel mbi të cilin të bazoj disiplinën dhe moralitetin, kam ftuar edhe<sup>81</sup> disa të tjerë që kishin sjellje të mirë dhe kishin arsim. Këto më ndihmonin të ruaj rendin dhe të lexoj dhe këndoj lavdet e shenjta; vetëm atëherë vura re që pa përhapjen e librave të këngëve dhe pa në lexim të mirë grumbullime festive do të ishin si një trup pa shpirt. Festën e Purifikimit (2 shkurt 1842), që akoma ishte festa e precetto, i kisha rreth njëzet fëmijë me të cilët për herë të parë mundëm të këndonim Lëvdoheni Zojën, o gjuhë besnike.<sup>82</sup>

Në festën e Virgjinës Annunziata ishin bërë 30 vetë. Atë ditë u pak festë. Në mëngjes nxënësit u shoqëruan për të marrë sakrementet e shenjta; në mbrëmje u kënduan një lavd dhe mbas katekizmit u treguar një shembull në formë predikimi. Nga dhoma ku ndodheshm deri atë moment duke qënë se ishim ngusht, u spostuam në kapelën e sakristisë që ndodhej aty afër.

Këtu Oratori bëhej kështu; çdo ditë feste krijohej mundësia për të marrë sakrementet shenjta të rrëfimit dhe kungimit; por në të shtune dhe një të diele në muaj ishte përcaktuar për këto detyra fetare. Në mbremje, në një orë të caktuar këndohej një lavd, bëhej katekizëm, pastaj një shembull, me shpërndarjen e ndonjë gjëje herë të gjithëve e herë me short.

Ndërmjet të rinjve që frekuentonin fillimet e Oratorit dua të përmend Giuseppe Buzzetti,<sup>83</sup> që erdhi gjithmonë rregullisht në mënyrë shembullore. Ai u afeksionua që shumë pas don Boscos dhe atij grupi të hareshëm, sa që nuk shkante më në shtëpinë në familjen e tij (të Caronno Ghiringhello)<sup>84</sup> siç bënin të gjithë të tjerët që ktheheshin tek vëllezërit o miqt e tyre. Dalloheshin eziandio vëllezërit e tij, Carlo, Angelo, Giosuè,<sup>85</sup> Giovanni Gariboldi dhe vëllezërit e tij, ishin punëtorë të thjeshtë krahu dhe tashti mjeshtër muratorë.

Në përgjithësi Oratori ishte i përbërë nga gurgdhendës, muratorë, suvatures, kalldrëmpunues, quadratori dhe të tjerë që vinin nga vendet e largëta. Atë duke mos

---

<sup>81</sup> edhe

<sup>82</sup> Lëvdoni Marinë o gjuhë besnike: këngë për nder të Virgjinës Mari, që do të bëhet shumë popullore në shtëpitë saleziane.

<sup>83</sup> Giuseppe Buzzetti (1832-1891) do të gjëndrojë i lidhur me dom Boscon për të gjithë jetën si bashkëpunëtor e do të bëhet salezian laik.

<sup>84</sup> Caronno Ghiringhello (sot Caronno Varesino): vend në provincën e Vareses, që 48 km larg Torinos.

<sup>85</sup> Carlo (1829-1891) dhe Giosuè (1840-1902), vëllezër të Giuseppes, do të bëhen sipërmarrës ndërtimi dhe do të bashkëpunojnë me don Boscon në ndërtimin e godinës së Valdoccas, në mënyrë të veçantë të kishës së Marisë Ndhimtare.

qënë të mësuar as me kishat as me shokë ishin të ekspozuar karshi rreziqeve të ndryshme sidomos në ditët e festave.

Teologu i mirë Guala dhe don Cafasso gëzoheshin për atë grup të fëmijësh dhe më jepnin me dëshirë figura, fletë, librete, medaljone, kryqe të vegjël për t'ia dhuruar. Nga ndonjë herë më jepnin rroba për të veshur ndonjëri që kishte më shumë nevojë; jepnin bukë të tjerë për disa javë, deri sa arrin me punë të fitonin vetë bukën. Biles, duke qenë se ishin rritur në numër, më lejuan që ndonjëherë ti grumbulloj këtë ushtri të vogël në oborri për të bërë pushimin. Në se localita do të më kishte lejuar do të kishim arritur më shumë se njëqind, por u desh të ndaleshim te rreth tetëdhjetë vetë.

Kur iu afroheshim sakreamendeve të shenjta vetë teologu Guala o don Cafasso vinin gjithmonë të në na bënin një vizitë dhe na tregonin ndonjë episod mbështetës.

Teologu Guala desh që për festën në nderim të Shën Anës, festës së muratorëve, mbas kremtimit të mëngjesit i ftoi të gjithë që të hanin mëngjesin me të. U grumbulluan rreth njëqind vetë në sallën e madhe e quajtur dhe salla e konferencave. Atë të gjithëve iu shërbye me bollëk kafe, qumësht, çokolatë, faver, briosh, biskota dhe të tjera ëmbëlsira, që janë gjëra shumë të lakmueshme për fëmijë. Gjithkush mund të imagjinojë se çfarë gjurme kishte në atë festë, dhe sa të tjerë do të kishin ardhur në se lokali do ti nxinte!

Festa ishte e gjitha kushtuar për të asistuar fëmijët e mi; gjatë javës shkoja ti bëja vizitë në mes të punës së tyre në ofiçina, në fabrika. Kjo gjë i jepte shumë forcë këtyre fëmijëve, që duke parë një mik që kujdesej për to; i jepte kënaqësi edhe pronarëve, që mbanin me dëshirë nën disiplinën e tyre këto të fëmijë të asistuar gjatë të gjithë javës dhe për më tepër në ditët e festave që ishin edhe ditët me rrezik më të madh.

Çdo të shtunë shkoja në burgje me torbë herë plot me duhan, herë me fruta, herë me copa buke gjithmonë si qëllim që ti rris këto të ri që po kalonin një fatkeqësi të ishin të drejtuar, të asistuar, ti bëja miq, ti thirrja që të vinin në Orator kur ato të dilnin nga ai vend dënimi.

#### **14. Shërbimi i Shenjtë – Zgjedhja e një detyre pranë Strehës (shtator 1844)**

Në atë periudhë kam filluar të predikoj publikisht në disa kisha të Torinos, në Spitalet e bamirësisë, në Hotelin e Virtutit, në burgje, në Kolegjin e Shën Françeskut të Paulës,<sup>86</sup> duke ndjekur tri ditshin, nëntë ditshin ose ushtrimet shpirtërore. Mbasi mbusha dy vitet e moralit kam bërë provimin e rrëfimit; dhe kështu munda më me shumë sukses të kultivoj disiplinën, moralin dhe të mirën e shpirtit të djemve të mi në burgje, në Orator dhe kudo që të ishin zanatet.

---

<sup>86</sup> Spitali i Bamirësisë dhe Hoteli i Virtutit: institucione bamirësie të krijuara që shek. XVI-XVII, e para e krijuar për tu kujdesur për pleqtë dhe të miturit e braktisur, e dyta për formimin artizanial të të rinjve të varfër. Kolegji i Shën Françeskut të Paulës, ishte një shkollë publike secondaria në qytet, në të cilën, deri në 1842, kishte qënë kapelan teologu Borel.

Ishte për mua ngushëlluese që gjatë javës dhe sidomos në ditët e festave të shihje rrëfyestoren time të rrethuar nga dyzet o pesëdhjetë të rinj që prisnin për orë të tëra për të pritur radhën për tu rrëfyer.

Kjo ishte diçka e zakonshme në Orator pothuajse për tre vite, pra deri në tetor të 1844.

Ndër kohë gjëra të reja, ndryshime dhe fatkeqësi me të cilat Provania hyjnore po na përgatiste.

Në përfundim<sup>87</sup> të tre vjeçarit të moralit duhej ti kushtohesha ndonjëres pjesë të përcaktuar të shërbimit të shenjtë. Xhaxhai plak i Comollos, don Giuseppe Comollo rektor i Cinzanos, me pëlqimin e arqipeshkvit më kishte ngarkuar detyrën e ekonomit administrator të famullisë, të cilën për moshën dhe sëmundjen nuk mund ta bënte më.<sup>88</sup> Teologu Guala ma dha vetë letrën e falënderimit të arqipeshkvit Fransoni, ndërsa përgatitesha për diçka tjetër.

Një don Cafasso më thirri pranë tij dhe më tha: “Tashti keni përfunduar kurset e studimeve tuaja; tashti duhet të punoni. Në këto kohë të korrat janë me shumë bollëk. Për çfarë e ndieni veten të gatshëm?”

- Atë që ty të pëlqen të më tregojë.

- Janë tri detyra: zëvendësdimësfamullitar në Butigliera në Asti; mësues morali këtu në Konvikt; drejtor i Spitalit të vogël afër Strehës.<sup>89</sup> Cilën do të zgjidhni?

- Atë që ti do të gjykosh.

- A nuk ndihni ndonjë prirje për njërin më shumë se për tjetër?

- Prirja ime është të kujdesem për të rinjtë. Ti mund të bësh me mua çfarë të duash; unë njoh vullnetin e Zotit në këshillën tënde.

- Në këtë moment kush e ka vend në zemrën tënde, që sillet pastaj në mendje tënde?

- Në këtë moment më duket se ndodhem në mes të një morie fëmijësh, që më kërkojnë ndihmë.

- Shkoni pra e bëni ndonjë javë pushim. Pas kthimit tuaj do t’ju tregoj destinacionin tuaj.

Mbas pushimeve don Cafasso la që të kalojë edhe ndonjë javë pa më thënë asgjë; unë në fakt nuk i kërkoja asgjë.

- Përse nuk më pyetni se cili do të jetë destinacioni juaj? më tha një ditë.

---

<sup>87</sup> Lexohet përfundoi.....

<sup>88</sup> Don Giuseppe Comollo vdiq në Cinzano me 1 janar 1843.

<sup>89</sup> Spitali i vogël, kështu quhej Spitali i shën Filomenës, themeluar nga markezja Giulia di Borolo për të pritur vajzat me handicap dhe të varfëra, nga 3 deri 12 vjeçe. Në atë periudhë po përfundonte ndërtimi (inagurimi u bë me 10 gusht 1845). Drejtimi i spitalit iu besua motrave të Shën Giuseppes. Streha [Vepra e shenjtë e Zojës Sonë Mbrojtësja e Mëkatënorve]: institucion i themeluar në 1822 nga e njëjta markeze për “shtrimet vullnetare, dhe krejtësisht falas për ato gra o të pamartuara mëkatnore, që kishin kryer dënimin për fajet e tyre, o që donin të linin me vullnetin e tyre vesin e rrugës, që jepnin prova të një pendese të plotë, dhe që tregonin që ishin të afta të vepronin mirë. Kjo shtëpi e shenjtë kishte një kapacitet për më tepër se njëqind të shtruar, të cilat mësoheshin në ushtrimin e virtyteve të punës dhe të atyre vetë nën drejtimin e motrave të institutit të shën Giuseppes”. Teologu Giovanni Borel, i cili i ngarkuari për anën shpirtërore të këtij instituti, i kishte porpozuar markezës don Gjon Boscon si kapelan të Spitalit.

- Sepse dua të njoh vullnetin e Zotit në vendimin tënd dhe nuk dua që të ketë asgjë nga dëshira ime.

- Bëni gati torbën dhe shkoni me teologun Borel; atje do të jeni drejtor i Spitalit të vogël të Shën Filomenës; do të punoni edhe në veprën e Strehës. Ndërkohë Zoti do t'ju vë në duar atë që do të bëni për rininë.

Në shikim të parë dukej që një këshillë e tillë të kundërshtonte dëshirat e mia, për këtë arsye drejtimi i një spitali, predikimi dhe rrëfimi në një institut që kishte më shumë se katërqind të reja, do të më hiqte kohë nga të tjera punë. Por këto ishin dëshirat e Qiellit, come ne fui in appresso assicurato.

Që nga çasti i parë që kam njohur teologun Borel gjithmonë kam parë në të një meshtar të shenjtë, një model të denjë për tu admiruar dhe për tu imituar. Çdo herë që mund të qëndroja me të jepte gjithmonë mësim të një meshtarie të zellshme, gjithmonë këshilla të mira, nxitje për të mirën. Në tre vitet që kalova në Konvikt qeshë nga ai i dërguar të shërbej në funksionet e shenjta, të rrëfeja, të predikoj seco lui. Në këtë mënyrë fushën e punës sime e njihja dhe në mënyrë familjare.

Kemi folur gjatë shpesh herë për ndjekjen e rregullave për tu ndihmuar reciprokisht për të shkuar në burgje dhe për përmbushur detyrat që na ishin besuar, dhe në të njëjtën kohë të kujdesesha për të rinjtë, që për nga moraliteti dhe braktisja tërhiqnin gjithmonë e më tepër vëmendjen e meshtarëve. Por si t'ia bëja? Ku ti mblidhja ato të rinj?

- Dhoma, më thotë teologu Borel, që është për ty, mund të shërbejë për një farë kohe për të mbledhur të rinjtë që vinin në shën Françesku e Assisit. Kur më vonë të shkojnë në ndërtesën e përgatitur për meshtarët afër Spitalit, atëherë do të mendojmë për një tjetër vend.

## 15. Një ëndërr e re

Të dielën e dytë të tetorit të atij viti (1844)<sup>90</sup> duhej ti thoja djemve të mi që Oratori do të transferohej në Valdocco. Për pa siguria e vendit, e mjeteve, e personave më lanë me të vërtetë sopra pensiero. Natën përpara shkova në shtrat me zemër të trazuar. Atë natë pashë një ëndërr të re që duke si vazhdimi i asaj që pashë në Becchi kur isha nëntë vjeç. Mendoj se është e mira ta shtroj para jush tërësisht.

Ëndërrova që isha në mes të një morie ujqish, dhish dhe kecash, qengjash, delesh, deshësh, qensh dhe zogjsh. Të gjithë së bashku bënin një zhurmë, një potere o më mirë të themi në mizëri që të fuste frikën edhe më trimave. Unë doja të ikja, kur një Zonjë, assai ben messa a foggia di pastorella, më bëri shenjë të ndiqja dhe të shoqëroja atë grigjë të çuditshme, ndërsa ajo printe. U sollëm duke ecur nëpër vende të ndryshme; bëmë tri ndalesa. Në çdo ndalesë shumë nga ato kafshë ktheheshin në qengja, numri i të

---

<sup>90</sup> E diele me 13 tetor 1844

cilëve rritej gjithmonë. Mbasi ecëm për një kohë të gjatë u gjenda në një livadh, ku ato kafshë kërcenin dhe hanin së bashku pa ngacmuar njëri tjetrin.

I këputur nga lodhja doja të ulesha buzë një rruge aty afër, por baresha më ftoi të vazhdoja ecjen. Mbasi bëmë edhe pak rrugë, u gjenda në një oborr të gjerë me portico harqe për rreth, në fund të cilin ndodhej një kishë. Aty vura re që katër të pestat e atyre kafshëve ishin kthyer në qengja. Numri i tyre ishte shumë i madh. Në atë çast arritën shumë barinj për ti ruajtur. Por atë qëndronin pak dhe niseshin menjëherë. Atëherë ndodhi një mrekulli. Shumë qengja shndërroheshin në barinj, që duke u rritur bënëin kujdes për të tjerët. Duke u rritur shumë në numër barinjtë, ndaheshin dhe shkonin në vendet tjera për të mbledhur kafshë të çuditshme dhe ti drejtonin në tjera vathë.

Unë doja të ikja, sepse më dukej se kishte ardhur koha për të celebruar meshën, por baresha më ftoi të shikoja mesditën. Duke vështruar pashë një fushë në të cilën ishte mbjellë meliga, patate, lakra, rrepa, sallata dhe shumë barishte të tjera.

- Shiko edhe një herë, më tha, dhe i hodha sytë përsëri.

Atë herë pashë në kishë të lartë të mrekullueshme. Një orkestër, në muzikë instrumentale dhe vokale më ftuan të këndoj meshë. Në brendësi të asaj kishe ishte një brez i bardhë, në të cilin me germa të mëdha ishte shkruar: *Hic domuz mea, inde gloria mea.*<sup>91</sup>

Duke vazhduar ëndrrën desha të pyes bareshën se ku gjindesha; se çfarë do të thoshe ajo e ecur, ato ndalesa, ajo shtëpi, kisha, pastaj kisha tjetër. “Ti do të kuptosh çdo gjë kur me sytë tuaj material do të shohësh në fakt se çfarë sheh tani me sytë e mendjes”. Duke pandehur se isha zgjuar, i thashë: “Unë shoh qartë dhe shoh me sytë material; e se ku shkoj dhe se çfarë bëj”. Në atë moment ra kambana e *Ave Maria* në kishën e shën Françeskut dhe unë u zgjova.

Kjo ëndërr u zgjati të gjithë natën; shumë gjëra të veçanta e shoqëruan. Atëherë pak ia kuptova domethënien sepse pak besim kisha, por i kuptova gjërat herë pas here kur jepni rezultatit e tyre. Biles më vonë, në lidhje me ëndrrën tjetër, më sherbeu si program për vendimet e mia.

## 16. Kalimi nga Oratori në Strehë.

E diela e dytë e tetorit kushtuar Të Zanunit e Marisë mora pjesë me djemtë e mi kalimin nga Oratori pranë Strehës. Në lajmërimin e parë u ndien të merakosur, por i thashë atyre se atje ambienti do të ishte më i madh, i gjithi për ne, për të kënduar, për të vrapuar, për të kërcyer dhe luajtur iu bë qejfi, secili priste me padurim të dielën e ardhshme për të parë të rejtat që ishin duke imagjinuar. Të dielën e tretë të atij tetori,<sup>92</sup> dita kushtuar pastërtisë së Virgjinës Mari, pak pas mesditës u duk një turmë djemsh të

<sup>91</sup> Këtu është shtëpia ime, prej këtu lavdia ime.

<sup>92</sup> Ishte me 20 tetor 1844.

moshave të ndryshe dhe të gjendjeve të ndryshme të vraponin për në Valdocco në kërkim të Oratorit të ri.

- Ku është Oratori, ku është don Bosko? shkonin nga të gjitha anët duke pyetur.

Askush nuk dinte të kthente përgjigje, sepse askush aty përreth kishte dëgjuar të flitej as për don Boskon as për Oratorin. Kandidatët duke besuar të tallur ngrinin zërin dhe kërkesat. Të tjerët duke u ndjerë të fyer përgjigjeshin me kërcënime dhe rrahje. Gjërat filluan të marrin hije të zymtë, kur unë dhe teologu Borel, dëgjuam të bërtiturat, dolëm nga shtëpia. Me daljen tonë pushoi çdo zhurmë, çdo grindje. Vrapuan grumbull rreth nesh; pyesnin ku ndodhej Oratori.

Iu tha se Oratori i vërtetë nuk kishte përfunduar ende, por ndër kohë mund të vinin në dhomën time, që, duke qenë e madhe, na shërbente mjaft mirë. Në fakt atë të diele gjërat shkuan mjaft mirë. Por të dielën tjetër, nxënësit e vjetër iu shtuan të tjerë të zonave përreth, nuk dija se si ti sistemoja. Dhoma, korridori, shkalla, e gjitha ishte një grumbull fëmijësh. Ditën e Gjithë Shenjtërve me teologun Borel duke qenë se isha duke rrëfyer, të gjithë donin të rrëfeheshim, e çfarë të bëja? Ishim dy rrëfyes, ishin më shumë se dyqind fëmijë. Njëri donte të nxiste zjarrin, tjetri donte ta fikte. Njëri sillte dru, tjetri ujë, kovë, mashë, qyrek, broke, catinella, karrige, shkarpa, libra dhe çdo lloj gjëje ishte vendosur mbrapsht e mbarë, ndërsa donin ti sistemonin për ti rregulluar gjërat.

- Nuk është e mundur më të shkohet përpara kështu, më tha teologu i dashur, ose duhet të shohim ndonjë vend më të përshtatshëm.

Megjithatë kaluan gjashtë ditë feste në atë vend, që ishte dhoma e parë sipër sa hysh në korridorin e Strehës.

Ndërkohë shkoj të fliste me arqipeshvin Fransoni, i kuptoj rëndësinë e projektit tonë. “Shkoni, i tha, bëni atë që ju duket më mirë për shpirtërat, unë do ju jap çdo gjë që për të cilat keni nevojë. Flisni me markezin Barolo,<sup>93</sup> ndoshta ajo mund t’ju japë ndonjë vend të përshtatshëm. Por më thoni: këto djem a nuk mund të shkojnë në famullitë e tyre?”.

- Këto djem shumica janë të huaj, të cilët kalojnë në Torino vetëm një pjesë të vitit. Nuk as se cilës famulli i përkasin. Shumë prej tyre janë në gjendje shumë të keqe, flasin në dialekt që pak merret vesh, kështu që kuptojnë pak dhe pak janë të kuptuar nga të tjerët. Disa janë të rritur dhe nuk guxojnë të hynë në një klasë me më të vegjlit.

- Pra, iu rikthye arqipeshkvi, është i nevojshëm në vend veçmas i përshtatshëm për ato. Shkoni pra. Unë ju bekoj ju dhe projektin tuaj. Për çfarë mundem t’iu ndihmoj, ejani kur të doni e do të bëj atë që është e mundur.

---

<sup>93</sup> Markezja Barolo: Giulia Vittorina Colbert dhe Maulévrier (1785-1864), lindur në Vandea (Francë), gruaja e markezit Tancredi Falletti di Barolo, i fundit trashëgimtar e një familjes aristokrate. Së bashku me të shoqin bëri të mundur krijimin e një kopshti për të mitur dhe institutet edukative; me të themeloi motrat e Shën Anës për të edukuar vajzat që vinin nga “civile condizione”. Iu kushtua kujdesit të burgjeve, duke i propozuar Qeverisë në reformë burgjesh që ajo vetë e përpunoi, e orientuar rikuperimit moral dhe civil nëpër mjet arsimit, punës, binde, gratifikimit dhe ndjenjës fetare. Themeloi në Kolegj (Streha) për edukimin e vajza të vogla nën moshën 11 vjeçe, jetime ose të braktisura nga familjet, të besuara kujdesit të motrave Maddalene. Ndërtoi edhe Spitalin e vogël, për të cilin është folur, dhe ka vazhduar me iniciativa të ndryshme kujdesi dhe bamirësie.

Në fakt shkuam të flisnim me markezin Barolo, dhe duke qenë se deri në gushtin e ardhshëm nuk do të hapej Spitali i vogël, zonja zemërmirë mbet e kënaqur që ne të shndërronim kapelen në dy dhoma të mëdha të caktuara për argëtim e meshtarëve të Strehës, kur ato të transferoheshin për të banuar. Për të shkuar tani në Oratorin e ri duhej të kaloje nga dera e spitalit, dhe në rrugicën e vogël që ndante Veprën Cottolengo<sup>94</sup> nga ndërtesa e përmendur, shkohej deri te shtëpia aktuale e meshtarëve dhe nëpër shkallën e brendshme ngjitesh në katin e tretë-katërt.

Aty ishte vendi i zgjedhur nga Provania hyjnore për të parën kishë të Oratorit. Aty filloi të quhej Shën Fraçesku i Sales për dy arsye: e para sepse markeza Barolo kishte për zemër të themelonte një kongregacion meshtarësh nën këtë emër, dhe për këtë qëllim kishte bërë në pikturë figurën e këtij shenjti që edhe tani ndodhet në hyrjen e kësaj ndërtese: arsyeja e dytë ishte sepse kjo pjesë e shërbimit tonë kërkonte qetësi dhe butësi, ishim nën mbrojtjen e këtij shenjti, deri sa të arrinte të merrte nga Zoti hirin që të mund ta imitonim në butësinë e jashtëzakonshme dhe në shpëtimin e shpirtrave. Tjera arsye ishte të ishim nën mbrojtjen e këtij shenjti, deri sa të na ndihmonte nga qielli që ta imitonim që të luftonim gabimet kundër fesë, veçanërisht për protestantizmin që kishte filluar fshehurazi të shtrihej në vendet tona dhe pikërisht në qytetin e Torinos.

Prandaj në vitin 1844, me datën 8 dhjetori, dita e kushtuar të Zojë së Papërlyer, me autorizimin e arqipeshvit,<sup>95</sup> në një ditë shumë të ftohtë, në mes të borës së lartë, që vazhdonte të binte hollë-hollë nga qielli, që bekuar kishëza e shumë dëshirueshme sospirata, u celebrua mesha e shenjtë, mjaftë të rinj bënë rrëfimin e kungimin, dhe unë përmbusha atë detyrë të shenjtë me një atribut lotësh ngushëllues, sepse shihja në mënyrë që më dukej e fiksuar vepra e Oratorit me qëllimin që të mblidhja rininë më të braktisur e të lëkundur mbasi të kisha kryer detyrat fetare në kishë.<sup>96</sup>

## **17. Oratori i Shën Martino dei Molazzi – Vështirësitë – Dora e Zotit**

Në kishëzën ngjitur me ndërtesën e Spitalit të vogël të shën Filomenës, Oratori mori një fillim të mirë. Në ditët e festave merrnin pjesë grupe të mëdha djemsh për të bërë rrëfimin e kungimin. Mbas meshe bëhej një shpjegim i shkurtër i Ungjillit. Mbas mesdite katetekizmi, këndimi i lavdeve të shenjta, mësim i shkurtër, litanitë lauretane

---

94 Vepra Cottolengo [Shtëpia e Vogël e Provanisë Hyjnore]: institucion i themeluar nga shën Giuseppe Cottolengo (1786-1842) në favor të të sëmurëve të varfër dhe të sëmurëve kronikë, të të paaftëve fizikë e psikikë, të moshuarve dhe lapsave. Për ti shërbyer Veprës Cottolengo themeloi dy kongregata mashkullore (njëra nga meshtarët dhe tjetra nga vëllezërit) dhe kongregata femërore (të jetës aktive dhe të jetës medituese). Sot ky institucion vepron në Itali dhe jashtë saj.

95 Shihet nga dokumentet e Curia torineze, e datës 7 dhjetor 1844.

96 Në mesazhin origjinal, në këtë pikë, don Bosco shënon: “Vila e të nderuarës konteshën Corsi Gabriella Peletta Nizza Monferrato 21 tetor 1873”. Teksti nuk është përcjellë në mesazhin e Berto. Shënimi tregon vendin në të cilin autori ka plotësuar faqet e mëparshme. Kontesha Corsi, “me meritë i quajtur nga ai me emrin e nënës”, për shumë vite strehoi don Boscon në vilën e saj në Nizza Monferrato “për të pushuar paksa në atë shtëpi pushim të freskët dhe të vetmuar, duke përfutur nga shëndeti, duke punuar pa qenë i shqetësuar.”

dhe bekimi. Gjatë ndërprerjeve të ndryshme të rinjtë ishin dëfreheshin gjatë pushime me argëtime të ndryshme. Kjo gjë bëhej në rrugicën e vogël që akoma ekziston ndërmjet manastirit të motrave Madalene dhe rrugës publike.<sup>97</sup> Kaluam aty shtatë muaj dhe ne mendonim që kishim gjetur parajsën tokësore, kur na u desh ta linim strehën e dashur për të shkuar dhe për të gjetur<sup>98</sup> një tjetër vend.

Markezja Barolo, edhe pse e shihte me sy të mirë çdo vepër bamirësie, megjithatë, duke iu afruar data e hapjes së Spitalit të saj (që u hap me 10 gusht to 1845) kërkoi që Oratori jonë të largohej për aty. Ishte e vërtetë që vendi i përcaktuar për kishëz, shkolla o argëtimi i të rinjve nuk kishte asnjë komunikim me pjesën e brendshme të ndërtesës, grilat ishin të fiksuara dhe të vendosur mbrapsht, nuk mundëm të bëjmë ndryshe veçse të bindemi. U bë një kërkesë e fortë në bashkinë e Torinos dhe me rekomandimin e arqipeshkivit Fransoni mundëm të transferonim Oratorin në kishën e shën Martino dei Molazzi ose më mirë të thuhet në mullinjtë e qytetit.<sup>99</sup>

Dhe ja në një të diele në mes të muajit maj të 1845; morëm stolat, inginocchiatoi, shalldanët, disa karrika, kryqet, kuadrot e pamjet, dhe gjithsecili mbante ato sende që munde, në këtë formë popullore emigrimi, ndërmjet të thirrurave, të qeshurës dhe keqardhjes shkuam dhe u sistemuam në vendin tonë kryesor aty ku thamë më sipër.

Teologu Borel bëri një diskutim të përshtatshëm përpara nisjes, ashtu edhe kur arritëm në kishën e re.

Ai shërbëtor i denjë i shenjtores, me një popullaritet që mund ta quajmë më fort të vetme se të rradhë, shprehi këto mendime: “Lakrat, o djem të dashur, në se nuk janë të mbjellura nuk bëjnë një kokët të bukur e të madhe. Të njëjtën gjë të themi për Oratorin tonë. Deri tani u transferua shpesh nga njëri vend tek tjetri, por në vende të ndryshme ku bëri ndonjë ndalesë pati gjithmonë një rritje të rëndësishme, dhe jo pa përfitim nga ana e të rinjve që erdhën këtu. Shën Françesku i Assisit e pa të fillojë me katekizëm dhe me pak këngë. Atëherë nuk mund të bëhej më shumë. Streha e desht,<sup>100</sup> për pak kohë për të bërë një ndalesë, siç është zakon të flitet për hekurudhën, dhe kjo deri sa të rinjtë tonë të mos mungonin të ato pak muaj në ndihmën shpirtërore dhe rrëfyese,<sup>101</sup> të katekizmit, të predikimeve dhe argëtimeve.

Pranë Spitalit të Vogël filloi Oratori i vërtetë, dhe na u duk se kishim arritur paqen e vërtetë, një vend i përshtatshëm për ne, por Provania hyjnore vendosi që duhej të shpërngulehim dhe të vinim këtu në shën Martin. A do të qëndrojmë këtu për shumë kohë? Nuk e dimë. Shpresojmë që po, por si do që të jetë ne besojmë që, si lakrat e

---

<sup>97</sup> Manastiri i Madaleneve: është manastiri i Murgeshave Penitenti të shën Maria Madalenës afër Spitalit të Vogël të Strehës.

<sup>98</sup> Don Bosco shkruan cecarcene.

<sup>99</sup> Molazzi [Molassi], i quajtur ndryshe edhe Mullinjtë Dora: një qendër e madhe për bluarjen e drithërave, i ndërtuar në shekullin e XIV, i zgjeruar dhe i modernizuar ndërmjet viteve ‘700 dhe ‘800. Gjendej disa minuta larg Strehë. Kërkimet në arkiva kanë mundur të na tregojnë që faktet e treguara në këtë kapitull ndodhin më vonë, mbas ngjarjeve të treguara në kapitullin e 18.

<sup>100</sup> ...lexohet ....

<sup>101</sup> ..lexohet...



mbjellura, Oratori ynë do të rritet në numër nga të rinjtë që duan virtytin, do të rritet dëshira për të kënduar, për muzikën, për shkollat e natës dhe për ato të ditës.

A thua pra do të kalojmë shumë kohë këtu? Mos të merremi me këtë mendim. Të hedhim çdo përkujdesje në duart e Zotit, ai do të ketë kujdes për ne. Është e sigurt që ai na bekon, na ndihmo e na mbështet. Ai do të mendojë për vendin e duhur për të bërë të ditur lavdinë e tij dhe për të mirën e shpirttrave tonë. Por duke qenë se, pra, hiret e Zotit formojnë një lloj zinxhiri në atë mënyrë që një hallkë është e lidhur me një tjetër, kështu, duke përfutur ne nga hiret e para jemi të sigurt që Zoti do të na dhurojë hire dhe më të mëdha; dhe ne, duke iu përgjigjur qëllimit të Oratorit, do të ecim nga virtyti në virtyt deri sa do të arrijmë në atdheun e bekuar ku mëshira e pafund e Zotit Tonë Jesu Krisht do të na japë çmimin që secili me veprat e mira të tija do ti meritojë”.

Në atë celebrim solemn ishin të pranishëm një grumbull i shumë i madh të rinjsh; dhe shumë emocion u këndua *Te Deum* për të falënderuar.

Praktikat fetare përmbusheshin si në Strehën. Por nuk mund të celebruhej meshë, dhe as të jepej bekimi në mbrëmje, kështu që nuk mund të bëhej as kungimi, që është elementi kryesor i themelit tonë. Momentet e argëtimit ishin jo pak të trazuar, të penguar për arsye se djemve i duhej të kalonin rrugë e sheshe përpara kishës ku kalonin shumë njerëz në këmbë, në karroca, kuaj e karroca të mëdha. Duke qenë se nuk mund të gjenim më mirë falënderuar Qielli për atë që na kishte dhënë, duke pritur një vend më të mirë. Por të tjera shqetësime na ranë përsipër.

Mullisit, shërbyesit, shitësit, duke mos duruar kërcimet, këngët dhe nga ndonjëherë të bërtiturat e nxënësve tonë, u alarmuan dhe së bashku bënë ankesa në bashki. Qe kjo koha kur u fillua të thuhej se ai grumbull djemsh ishin të rrezikshëm, që nga çasti në çast mund të bënin kryengritje dhe revolucion. Këto gjëra thoshnin të mbështetur nga dëgjesa e plotë me të cilën ato pranonin çdo shenjë të superiorit. Shtohet, pa bazë, që djemtë bënin njëmijë sherre në kishë; jashtë kishë, në rrugicë, e dukej se Torinoja do të pushtohet në se ne do të vazhdonim të mbledheshim në atë vend.

Kulmi i kësaj arriti me një letër të shkruar nga një sekretar i mullinjve kryetarit të bashkisë të Torinos, në të cilën kishte mbledhur të gjitha zërat përçarës dhe duke zmadhuar sherret imagjinare,<sup>102</sup> thonin që ishte e pamundur që familjet që punonin në atë zonë të mund të vazhdonin detyrat e tyre dhe të kishin qetësinë.

Biles arriti të thoshte që aty ishte një farishtë imoraliteti. Kryetari i Bashkisë, edhe pse i bindur për ato të dhëna të pabaza, shkuan një letër calda ku shkruante se duhej ta qonim menjëherë diku tjetër Oratorin tonë. Keqardhje e përgjithshme, ofshama të padobishme! Na u desh të shpërngulehim menjëherë.<sup>103</sup>

---

<sup>102</sup> Anash letrës të Berto lexojmë një shënim me dorë të sekretarit: “Kryetari i bashkisë dërgoi për të verifikuar dhe gjeti mure, rrethimin e jashtëm, dyshtënë, të gjitha gjërat e kishës në vendin e vet. Dëmi qëndronte se një djalë me majën e një gozhde kishte bërë një vijë të shkurtër në mur”.

<sup>103</sup> Sipas rikonstruktimit historik të dokumentuar, katekizmi bëhej në kapelen e Mullijve nga 13 korriku deri të dielën me 28 dhjetor të 1845; letra e zyrës teknike e Komunës (Zyra Financiare) që urdhëroj shpërngulje brenda datës 1 janar 1846, mban datën 14 nëntor.

Por ama është mirë të shënohet që sekretari me emrin Cussetti (kurrë më për tu publikuar) autori i letrës së famshme, shkruan për herë të fundit, sepse qe goditur nga një dridhje e fortë e dorës së djathë, dhe mbas tre vitesh vdiq. Zoti vendosi që djali i tij të braktisej në mes të rrugës dhe u detyrua të kërkonte bukë e ricetto në strehën që u hap më vonë në Valdocco.

## **18. Oratori në Shën Pjetron in Vincoli – Shërbyesja e kapelanit – Një letër – Një aksident i trishtuar**

Duke qenë se kryetari i bashkisë dhe në përgjithësi bashkia ishin të bindur nga insussistenza për sa shkruhej kundër nesh, kështu me një kërkesë të thjeshtë, dhe me rekomandimet e arqipeshkvit, mundëm të gjenim mundësinë për tu mbledhur në oborrin e kishës së Cenatafio të Shenjtërueshmit Kryq e quajtur gjerësisht Shën Pietro in Vincoli.<sup>104</sup> Kështu që mbas dy muajsh qëndrim në Shën Martino na u desh me të transferoheshim në një tjetër vend, që ishte më i përshtatshëm për ne. Përgjatë galerisë, hapësirës së oborrit, kisha e përshtatshme për funksionet e shenjta, e gjitha kjo shërbeu për të ndezur entuziazmin tek të rinjtë, sa që dukeshin të ngazëllyer nga gëzimi. Por në atë vend ekzistonte një armik i tmerrshëm, që ishte injoruar prej nesh. Nuk ishin të vdekurit, që të shumë pushonin në varrezat aty afër, por një person i gjallë, shërbyesja e kapelanit. Ajo sapo dëgjoji këngët e zërat, të themi, edhe të bërtiturat e nxënësve, doli nga shtëpia me shumë zemërim, e me shaminë në kokë e me duar mbi ije dhe filloi ti drejtohej shumicës së lojçakëve. Me të shante dhe një vajzë e vogël, një qen, një mace, të gjitha pulat e shtëpisë në mënyre sa dukej se së shpejti po shpërthente një luftë evropiane. U mundova të gjej mënyrën që ti afrohem me kujdes, duke i bërë të ditur se atë fëmijë nuk kishin qëllime të këqija, che si trastullavano, nuk bënin biles as mëkat. Atëherë u soll kundër meje dhe më që të shikoja punën time.

Në atë momente e pashë të arsyeshme të mos e vazhdoj pushimin, të bëja pak katekizëm, të thoja Rruzaren në kishë, pastaj ikëm me shpresë që të mblidheshim me qetësi të dielën e ardhshme. Por krejt e kundërta. Atëherë aty nga mbrëmja arriti kapelani, shërbyesja e mirë iu soll rrotull e duke i quajtur don Boskon e djem e tij revolucionarë, profanë të vendeve të shenjta e të gjithë hora e faqezezë, shtyu të zotin të shkruante një letër bashkisë.

---

<sup>104</sup> Ngjarja e treguar në këtë kapitull ndodhe të dielën me 25 maj 1845, përpara transferimit në shën Martino pranë Mullinjve. Shën Pietro in Vincoli: ndodhej jo larg Strehës dhe jo larg veprës Cottolengo, në fushat aty afër Depove ushtarake. Sëbashku me varrezat e shën Lazzaros (të vendosura në anën tjetër të qyteti), ishte ndërtuar në 1777; “të dyja kishin të njëjtën formë, katrore me dyer në të tria anët, në fund të kishës, dhe në mes një oborr me pusët e varreve të përbashkëta, në të cilët ishin grumbull arkivole dhe kufoma njëra mbi tjetrën”, ndërsa varret private ndodheshin “nëntokë që ishte mbas galerisë”. Në krah të varrezave të shën Pietro in Vincoli, ku nuk bëheshin më varrime që nga viti 1832 (mbas ndërtimit të varrezave të mëdha të përgjithshme), ishte një hapësirë, “e mbyllur nga muret, ku akoma ishte e pranishme [1851] varroseshin të dënuarit”. Ndërtesa, nga ku janë marrë eshtrat e të varrosurve, ekziston akoma dhe përdoret për manifestimet kulturore dhe ekspozitat.

Shkroi në diktimin e fantesca, por me aq shumë hidhësi, sa që menjëherë iu dha një urdhër kapje për pesë prej nesh në se do të ktheheshim aty. Me dhimbje e them, por ajo ishte letra e fundit që kapelani don Tesio, i cili e shkroi të hënën, e pas pak orësh e përshkoi pika që e bëri të paaftë pothuajse në çast.<sup>105</sup> Dy ditë mbas kësaj një fat i ngjashëm e preku dhe fantesca. Këto ngjarje u përhapën dhe bënë shumë përshtypje tek shpirtërat e rinjve dhe tek të gjithë ato që dëgjuan se çfarë kishte ndodhur. Tundimi për ardhur, për të dëgjuar këto raste të trishtuara ishte i madh tek të gjithë; por duke qenë se na ishte ndaluar që të mblidheshim në Shën Pjetër in Vincoli, dhe duke qenëse nuk qe e mundur që të bëhej njoftimi e duhur, askush nuk mund të imagjinonte, bile as unë, se në çfarë vendi do të bëhej i mundur grumbullimi.<sup>106</sup>

## 19. Oratori në shtëpinë Moretta

Të dielën që pasoj mbas atij ndalim një shumicë të rinjsh shkuan në Shën Pietro in Vincoli; sepse nuk qe e mundur ti jepej atyre ndonjë lajmërim. Duke gjetur çdo mbyllur e gjithë ajo turmë u derdh në banesën time pranë Spitalit të Vogël. Çfarë të bëja? Unë ndodhesha në mes të një morie mjetesh të kishës e të pushimit; një grumbull vogëlushësh shkonin pas hapave të mi, ndërsa unë nuk kisha as një pëllëmbë vend ku mund ti prisja.

Megjithatë fsheha hallet e mia dhe me të gjithë tregohesha në humor të mirë dhe të gjithë gëzoheshin ndërsa tregoja një mijë mrekullitë rreth Oratorit të ardhshëm që deri atëherë egzistonte vetëm në mendje time e në vendimet e Zotit. Pastaj, për ti plotësuar ditët e festave në ndonjë farë mënyre, i qoja ndonjë herë në Sassi,<sup>107</sup> ndonjë herë në në Madonna del Pilone,<sup>108</sup> në Madonna di Campagna,<sup>109</sup> në malin e Kapuçinëve<sup>110</sup> edhe bile deri në Superga.<sup>111</sup> Në këto kisha merrja lejen për të celebruar Meshën Shejte në

<sup>105</sup> Giuseppe Tesio (1777-1845), ish frat kapuçin me origjinë nga Racconigi (Cuneo), vdiç të mërkurën me 28 maj.

<sup>106</sup> Nga dokumentat e arkivës nuk rezulton që don Tesio të ketë shkruar një letë armiqësore don Boskos; Organet nuk ndaluan djemt që të përdornin Oratorin, por anëtarëve të “kongregatës së katekistave të Shën Pelagia” që mblidheshin në kapelen të dielave pasdite për të celebruar vespret, pa respektuar oraret e caktuara nga don Tesio. Mbi këtë ngjarje dhe mbi keqkuptimet që rrodhën nga interpretimi i fakteve nga ana e don Boskos, Oratori i don Boskos, 204-211.

<sup>107</sup> Sassi: vend rreth 3 km larg Torinos, në anën e një kodre që ishte në krah të djathë të lumit Po.

<sup>108</sup> Madonna del Pilone: “kështu quajta një katund të vogël një mile larg Torinos, në të djathë të lumit Po. Aty ndodhet një shenjtore e nderuar e të Shenjtëruarës Virgjin Mari, që në fillimet e saja lidhej me një mrekulli të ndodhur në 1644, ku një vajzë me emrin Margarita Molar e cila kishte rënë fatkeqësisht në rrotat e një mulliri, ch'eravi allora, me ndërmjetësinë e Virgjinës së Bekuar, pamja e saj ndodhej e varur në kolonë aty afër, kishte dalë prej rrotave gjallë e shëndosh”.

<sup>109</sup> Madonna di Campagna: famulli e lidhur me një kuvend Kapuçinësh, gjendet ndërmjet rrugës që lidh Torinon me Venarian, 3 km nga qyteti.

<sup>110</sup> Monte dei Cappuccini: kishë e bukur pesëqind vjeçare e arkitektit Ascanio Vitozzi (1539-1615), ku shërbeni fretërit Kapuçinë, që dominon qytetin nga një reliev pyjor pranë rrjedhës së djathë të lumit Po.

<sup>111</sup> Superga: një bazilikë monumentale e vendosur mbi kodrën që dominon Torinon; i ideuar dhe e ndërtuar nga arkitekti Filippo Juvarra, si rrjedhojë e betimi të nga Vittorio Amedeo II në shtator të 1706, gjatë pushtimit të trupave franceze. Në kriptën ndodhen varret e disa anëtarëve të familjes mbretërore.

mëngjes me shpjegimin e ungjillit. Në mbrëmje bëhej pak katekizëm, këngët e lavdeve, ndonjë tregim, pastaj kthimi, shëtitje deri në orarin për të kthyer në familjet e tyre. Dukej se gjendje kritike mund ta kthente në hi çdo mendim për Oratorin, e në fakt numri i pjesëmarrësve rritej shumë.

Ndërkohë ishim në muajin nëntor (1845) stinë jo e përshtatshme për të bërë shëtitje o ecje jashtë qytetit. Dakord me Teologun Borel kemi marrë me qira tri dhoma në shtëpinë e don Moretta,<sup>112</sup> që ishte afër, pothuajse përballë kishës së Marijes Ndhimtare. Tani ajo shtëpi nga riparimet e shumta duhet bërë nga e para. Aty kaluam katër muaj, lokal i pamjaftueshëm, por të kënaqur që mund paspaku që në ato dhoma të mblidhnim nxënësit tanë, ti mësonim dhe ti jepnim mundësinë e duhur për tu rrefyer. Biles po në atë dimër kemi filluar shkollat e mbrëmjes. Ishte hera e parë që në vendet tona flitej për një këtë lloj shkolle; për këtë u bë zhurmë e madhe, dikush pro, e të tjerët kundër.

Në atë kohë, bile qe që u propaganduan disa thashetheme shumë të çuditshme. Disa e quanin don Boskon revolucionar, të tjerët e merrnin për të marrë ose heretik. Kështu arsyetoje: “Ky Orator largon të rinjtë nga famullitë, kështu që famullitari do ta shohi kishën bosh, as që do ti njohi më vogëlushtë, për të cilët do të japë llogari përpara Zotit. Pra don Bosko ti dërgojë vogëlushtë në famullitë e tyre e të mos mbledhin me fëmijët e vendeve të tjera”.

Kështu më thonin dy përgjegjës të famullive të këtij qytet, që bënë vizitë në emër edhe të kolegëve të tjerë.

- Të rinjtë që mbledh, ato më përgjigjeshin, duke mos shqetësuar frekuentimin e famullive, sepse pjesa më e madhe e tyre nuk njohin as famullitar as famulli.

- Përse?

- Sepse janë pothuajse të gjithë huaj, të cilët janë të braktisur nga prindërit në këtë qytet, ose vijnë për të gjetur punë, që nuk mund ta kenë. Savojardaz, svicerjan, valdostan, biellines, novarez, lombardas janë atë që frekuentojnë rregullisht grumbullimet e mia.

- A nuk mund ti qojmë këto të rinj në famullitë përkatëse?

- Nuk i njohin.

- Përse të mos ia bësh të njohur?

- Nuk është e mundur. Largimi nga vendi i lindjes, ndryshueshmëri në të folur, pa siguria për një strehim, dhe mos njohja e vendeve e bëjnë të vështirë për të mos thënë të pa mundur për ti dërguar në famullitë. Për më tepër shumë prej tyre janë të rritur: ndonjëri i prek të 18, të 20 biles edhe të 25 vite, dhe janë nuk dinë pothuajse asgjë nga

---

Kisha, me plan rrethor, ka një kupolë të lartë 75 metër dhe ka anash 2 kompanjela të lartë 60 metër. Në ndërtesën në krah të bazilikës ka qëndron akademia kishtarë, ku ndodhet një bibliotekë e rëndësishme, sot e vendosur pranë Bibliotekës Mbretërore të Torinos.

<sup>112</sup> Giovanni Battista Moretta (1777-1847), kapuçin shekullar i 1803. Shtëpia ishte pronë e tija, ishte një ndërtesë dy katërshe, me “kantinë e stallë, nëntë dhoma të banueshme në katin përdhes” dhe dy shkalla druri nëpër mjet të cilave “ngjiteshe në katin e sipërm ku një korridor i gjatë të jepte mundësinë e hyrjes në nëntë dhoma të tjera [.....]. shtëpia nga lindja kufizohej nga kopshti Filippi, ku shfaqej porta hyrëse”.

gjërat e besimit. Cili do të ishte ai që do ti bënte të shoqëroheshin me vogëlushë 8 apo 10 vjeçar, shumë më të ditur se ata?

- Nuk mundeni ju vetë ti drejtoheni që të vinë të bëjnë katekizëm në kishat famullitare?

- Do të mundesha të vij tek njëra famulli, por jo tek të gjitha. Pastaj duhet të shihet se çdo famullitar do të kishte kujdes ti merrte, ose ti dërgonte atij që mbledh këto vogëlushë dhe ti drejtojë në famullitë përkatëse. Por edhe kjo gjë është e vështirë, sepse janë jo të pakët ato që janë të shpërndarë dhe edhe discoli, të cilët të tërhequr nga lojërat, nga shëtitje që bëjmë mes nesh, zgjidhen duke marrë pjesë edhe në katekizëm dhe ndër të tjera vepra mëshire. Për këtë arsye duhet të jetë e nevojshme që çdo famulli duhet të ketë eziandio një vend të përcaktuar ku mund të mblidhen e të mbahen këto fëmijë në lojëra të këndshme.

- Këtë gjëra janë të pamundura. Nuk janë ambientet, as meshtarët nuk kanë ditë të lira në ditët e festave për këto punë.

- Pra?

- Pra, po arsyetojmë mirë, para së gjithash të përcaktojmë ndërmjet nesh cila është gjëja më e mirë për të bërë.

Kjo çështje u diskutuar ndërmjet famullitarëve torinez, në se Oratorët duhej të promovoheshin o të riprovonin. U tha pro e kundër. Kurati i Borgo Dorës don Agostino Gattino<sup>113</sup> me teologun Pontasi meshtar i Shën Agostino,<sup>114</sup> më kthej përgjigje në këto terma: “Famullitarët e qyteti të Torinos, të mbledhur në konferencën e tyre të zakonshme, trajtuan edhe të mirat e Oratorëve. Mbase u matën frikët dhe shpresat, nga njëra dhe nga tjetra anë, duke qenë se asnjë famullitar nuk mund të sigurojë një Orator në famullitë e tyre, i japin zemër meshtarit Bosko të vazhdojë deri sa të merret një tjetër vendim”.

Ndërsa po ndodhnin këto gjëra, ishte duke ardhur pranvera e vitit 1846. Shtëpia Moretta ishte e banuar nga shumë qiraxhi, të cilët, të shastisur nga të thirrurat dhe nga zhurmat e vazhdueshme të ecejaket e fëmijve u ankuan tek i zoti i shtëpisë, duke deklaruar të gjithë se nuk do të paguan qiranë, në se nuk pushonin menjëherë këto grumbullime. Kështu që meshtari i mirë Moretta iu desh të na njoftonte që të kërkonim me një herë një vend tjetër ku të mblidheshin djemtë tanë në se do të mbanim në jetë Oratorin tonë.

---

<sup>113</sup> Agostino Luigi Gattino (1819-1869): kurato i famullisë së Shenjtërve Simone e Giuda në Borgo Dora, në drejtimin e të cilit ndodhej Strega e Oratorit, kur u sistemua në shtëpi Pinardi. Famullia e Borgo Dorës kishte në ato vite 20.000 banorë; ishte më e hapura dhe më e varfëra e qytetit: “Territori nën drejtimin e kësaj famullie fillonte nga zona e Martinettos, dhe arrin deri në grykën e lumit Po, pranë ndërtesës së R. Parco [.....]. Shumë e dëmshme është ajri që thithet në këto zonë për shkak të lagështirës së prodhuar nga ujrat e shumë të rrethojnë. Para pak vitesh është urdhëruar nga vikariati që të gjitha ofiçinat e fabrikuesve të makinave të mëdha, kazanpunuesit, vozapunuesit, dhe të mjeshtërve të tjera për të liruara .....

<sup>114</sup> Teologu Vincenzo Ponsati (1800-1874), nga 19827, ishte kurat i famullisë së Shenjtërve Filippo e Giacomo, që kishte qendër në kishën e Shën Agostinit, dhe kapelan i burgjeve senatoriale të Torinos (ku mbaheshin deri në 300 të burgosur), ndihmohet në këtë detyrë nga don Cafasso, nga teologu Borel dhe nga të tjerë.

## 20. Oratori në një livadh – Shëtitja në Superga

Me shumë keqardhje dhe jo pa shqetësim të grumbullimeve tona, në mars të 1846 na u desh të linim shtëpinë Moretta dhe të merrnim me qira një livadh nga vëllezërit Filipi,<sup>115</sup> ku aktualisht ka filluar një fonderi e gisës. Unë gjendesha aty në qiell të hapur, në mes të një livadhi, të rrethuar me barëra të këqija e shkurre, ku mund të hynte kush të donte. Fëmijët ishin treqind a katërqind, të cilët gjetën Parajsën tokësore në këtë Orator, ku si tavani, ashtu edhe muret rrethuese ishin nën qiell të hapur.

Por ky vend si mund<sup>116</sup> të viheshin në praktikë gjërat e besimit? Alla bell'e meglio këtu bëhej katekizmi, këndoheshin lavdet, këndoheshin vespret, pra teologu Borel ose unë hipnim sipër një bregu o sipër një karrige dhe drejtonim predikimet tona të shkurta të rinjve, që me shume etje vinin të na dëgjonin.

Diskutimet bëheshin kështu: në ditët e festave, në mëngjes herët, unë gjindesha në livadh ku shumë të rinj i gjeja aty. Ulesha ndenjtur buzë një bregore për të dëgjuar rrëfimet e njërit, ndërsa të tjerët përgatiteshin ose bënë falënderimet, ku pas kësaj jo të pakët fillonin lojrat e pushimit. Në një farë pike të mëngjesit binte tromba, që mblidhet të gjithë fëmijët, me një tjetër tingull trombe fillonte heshtja, që më bënte vend për të folur dhe për të treguar se ku duhej të shkonim për të ndjekur meshën shenjte dhe për të bërë kungimin.

Ngandonjëherë, siç thuhet, shkonim në kishën e Madonna di Campagna, në kishën Consolata, në Stupinigi<sup>117</sup> o në vendet e përmendura më sipër. Dhe duke qenë se zakonisht bënim shëtitje të shpeshta në vende edhe të largëta, kështu unë i përshkruaja një veprim në Superga, prej këtu do të njihej si të bëheshin të tjerat.

Sa po mblidheshin fëmijët në livadh dhe sa i jepej atyre kohë për të luajtur sa me gjyle, sa me rrasa, sa me shkopinj, etj., binte boria, pra një tingull që shënonte grumbullimin e nisjen. Sigurohesha që gjithsecili më përpara të ndiqte meshën dhe mbas orës nëntë niseshim për nga Superga. Dikush mbarte shporta me bukë, dikush dhjathin kaçkavall o sallamin o frutat gjëra të nevojshme për atë ditë. Mbahej qetësi deri sa linim shtëpitë e banuara të qytetit, pas kësaj fillonte zhurma, këngët e të bërtiturat, por gjithmonë pa prishur rreshtin.

Pasi mbërrinim në këmbët e së përpjetës, që të qonte në bazilikë, gjeta një kalë të vogël që, i mbathur siç duhet, meshtari Anselmetti<sup>118</sup> kurato i asaj kishe ma kishte

---

<sup>115</sup> Vëllezërit Filippi: Pietro Antonio e Carlo, pranarë shtëpishë e tokash në afërsi të shtëpisë të don Morattës.

<sup>116</sup> .....

<sup>117</sup> Stupinigi: vend rreth 8 km nga qendra e qytetit, drejt jugut, ku ndodhej në vilë e mrekullueshme e përdorur nga mbreti gjatë periudhës së gjuetis, e projektuar nga arkitekti Filippo Juvarra (1678-1736), në anë kishte një park të gjërë dhe një pyll të ngjeshur.

<sup>118</sup> Giuseppe Maurizio Anselmetti (1778-1852), kurato i famullisë të Lindje së Marisë, jo larg nga bazilika e Supergës.

dhënë. Aty biles gjeja dhe një letër të teologut Borel, që na kishte paraprirë, në të cilën thoshte: “Eja qetë me djemtë tonë të dashur, supa, gjella, vera janë gati”. Unë hipa mbi të kalë dhe pastaj lexova me zë të lartë letrën. Të gjithë u mblohdën rreth kalit të vogël dhe, sapo dëgjuan këtë letër, njëzëri filluan të rrahin shuplakë dhe të bërtasin me ovacion, dhe thirrur dhe duke kënduar. Kush e mbante kalin nga veshët, kush hundën o bishtin, herë duke shtyrë të shkretën kafshë, herë duke e kalëruar. Kafsha e butë pranonte në qetësi duke dhënë shenja të një durimi më të madh se do të kishte pasur ai që i rrinte shpinë.

Në mes asaj gjullurdie ne kishim muzikën tonë që përbëhej vetëm nga një tambur, një trombë dhe një kitarë. Çdo gjë ishte e çakorduar, por shërbenin për të bërë zhurmë dhe zërat e fëmijëve mjaftonin të bënin një harmoni të mrekullueshme.

Të lodhur nga të qeshurat, lojërat, këngët biles edhe nga të bërtiturat, arritëm në vendin e caktuar. Të vegjlit, të djersitur, u mblohdën në oborrin e shenjtores dhe qenë më shumë të kujdesshëm sesa ishte e nevojshme grykësia e oreksit të tyre. Mbas disa një fije pushimi i mblohdha të gjithë dhe i tregova imtësisht historinë e mrekullueshme të asaj bazilike, të varreve mbretërore që ndodheshin nën kishë, dhe për Akademinë kishtarë<sup>119</sup> që ishte këtu e ertta nga Carlo Albeto<sup>120</sup> dhe e pranuar nga ipeshkvijtë e Shteteve Sarde. Teologu Guglielmo Audisio,<sup>121</sup> që ishte drejtor, bëri shpenzimin e hijshëm për një supë dhe gjellë për të gjithë të pranishmit. Famullitari dhuroi verën dhe frutat. Na desh nja dy orë kohë për të parë të gjithë ambientet, dhe pastaj u mblohdëm në kishë, ku gjendej dhe shumë popull. Në tre të pasdites bëra një diskutim të shkurtër nga pulpito, mbas kësaj kush pas zë kënduam një *Tantum ergo* me muzikë, ai kor i

---

<sup>119</sup> *Akademia Kishtarë e Supergës*: qendra superiore e studimeve teologjike e kanonikë e rezervuar për të rinjtë e diplomuar në Teologji dhe në Drejtë në Universitetin e Torinos, të dalluar për inteligjencën dhe cilësitë morale, të paracaktuar për karrierën akademike dh kishtarë. E themeluar në 1730 nga Vittorio Amadeo II, e ndërprerë në periudhën gjakobine, u rihap nga mbreti Carlo Alberto në 1834. Ishte “e përbërë nga një mbrojtës që të ishte kryetar, nga dy profesorë, prej të cilëve njëri drejtor, e tjetri zëvendësdrejtor dhe prej pesëmbëdhjetë anëtarësh [.....]. Për tu pranuar aty ishte e nevojshme të ishte i diplomuar në teologji, o në ligje në njërin prej universiteteve shtetërore. Anëtarët prisnin për katër vite me studime të teologjisë morale, të kanonikës, të gojëtarisë së shenjtë, të historisë kishtarë” (CASALIS, Dizionario, XXI, 88-97).

<sup>120</sup> *Carlo Alberto i Savoja-Carignano* (1798-1849), i bërë mbret në 1831, kishte vazhduar dhe zgjeruar me reformat e filluara nga Carlo Felice, ndër të cilat ato të kodeve të organizimit ekonomik e tregtar të mbretërisë. Mbas dekretit të emancipimit valdes të ebreve, lejon, me 4 mars 1848, një Statut të frymëzimit liberal (*Statuti themelor i Mbretërisë së Savojës*, zakonisht i quajtur *Statuti albertin*), u vendos në krye të lëvizjes patriotike për bashkimin italian. Me 23 mars 1849, mbas humbjes së luftës kundër Austrisë, abdikoj në favor të të birit, Vittorio Emanuele II. Vdiq katër muaj më vonë, me 28 korrik, në Oporto, ku ishte tërhequr për të banuar.

<sup>121</sup> *Guglielmo Antoni Audisio* (1802-1882), teolog dhe shkrimtar, drejtor i Akademisë Kishtarë të Supergës deri në vitën 1849, kur, i akuzuar për konservatorizëm, qe i detyruar të largohet nga Shteti dhe të transferohet në Romë. Pio IX në 1850 i besoi katedrën *E Drejta natyrale e njerëzve* në Universitetin La Sapienza, dha mësim deri në 1871. U emërua kanonik i Shën Pjetrit. Vitet në Romë qenë vite shumë frytdhënëse për publikimet, gjatë të cilave u bë pjesë e rosminianesimo. Mbas çarjes së Portës së Shenjtë iu dha leja për pushim. Në një libër, në të cilin mbështeste mundësinë e pajtimit ndërmjet Shtetit italian dhe Kishës (Të shoqërisë politike dhe fetare respekt në .....1876), mori dënimin nga Zyra Shenjte, të cilës iu nënshtrua. Tregohet për një diskutim ndërmjet don Boskos dhe Audisios, në janar të vitit 1870, për oportunitetin e dogmës mbi pagabueshmërisë pontifikale.

zërave të bardhë, si për herë të parë, ngjalli shumë admirim. Në orën gjashtë u lëshuan në qiell disa sfera aerostatike, pastaj, në mes falënderimesh të atyre që kishin përfituar, u nisën për tu kthyer në Torino. E njëjta mënyrë e të kënduarit, e të qeshurit, të vrapuarit e ndonjë herë duke u lutur përshkoi rrugën tonë. Sa arritëm në qytet, herë pas here kur dikush arrinte afër shtëpisë së tij, heshte dhe në fund shkonte në shtëpi. Kur unë arrita në Strehë ishin akoma me mua 7 a 8 të rinj nga më të fortët që mbartnin mjetet e përdorura gjatë ditës.

## 21. Markezi Cavour dhe kërcënimet e tija – Të tjera shqetësime për Oratorin

Nuk mund të thuhet se çfarë entuziazmi ngjallnin tek të rinjtë këto shëtitje. Të lidhur pas kësaj përzierje të besimit, të lojërave, të shëtitjeve, gjithsecili bëhej shumë i lidhur pas meje sa që jo vetëm ishin dëgjueshëm urdhrave të mia, por dëshironin që ti besoja ndonjë incumbenza për të kryer. Një ditë një karabinier duke më parë se me një shenjë të dorës të vendosja qetësinë në një grup prej katërqind fëmijësh, që kërcenin e hidheshin nëpër livadh, lëshoi me të madhe një fjalë: “Në se ky prift do të kishte qenë gjeneral armate, me shumë mundësi do të luftonte kundër ushtrisë më të fuqishme të botës”. Bindje dhe dashuri e nxënësve të mi shkonte deri në marri. Kjo gjë i dha mundësi zërave që don Bosko me fëmijët e tij mund të krijonte nga momenti në moment një revolucion. Një pohim i tillë, që mbështetej mbi qesharaken, gjeti përsëri vend ndërmjet autoriteteve vendore e në mënyrë të veçantë pranë markezit Cavour,<sup>122</sup> babai i të famshëmve Camillo<sup>123</sup> e Gustavo,<sup>124</sup> në atë kohë vikarë të qytetit, ishte sikur të thojë

---

<sup>122</sup> Michele Giuseppe Benso, marchese di Cavour (1781-1850)

<sup>123</sup> Camillo Paolo Filippo Giulio Benso, conte di Cavour (1810-1861), fëmija më i vogël i Michele, uomo d'affari, studiues i teorive ekonomike dhe i teknikave të reja agrare, gazetar i drejtimit liberal i moderuar. Mbas 1848 doli në pah si një person politik inovativ. Në cilësinë e ministrit të Bujqësisë dhe Tregtisë (1850) dhe e Kryeministrit të mbretërisë së Sardenjës (1852-1860) promovon një linjë politike liberaliste, duke i dhënë një shtyrje të fortë veprave publike dhe të industrisë. Zhvilloi një aksion të fortë diplomatik e politik që çoi Piemonten, nëpër mjet aleancës me Francën në luftën e dytë të pavarësisë kundër Austrisë (1859), aneksimin e një pjesë të madhe të gadishullit dhe bashkimin kombëtar. Formoi të parin Parlament kombëtar dhe bëri të mundur shpalljen e Mbretërisë së Italisë, që ndodhi me 17 mars 1861.

<sup>124</sup> Gustavo Filippo Benso, marchese di Cavour (1806-1864), fëmija e madh e Michele, i diplomuar në ligje, studiues i filozofisë dhe publicistikës, e kujdesshëm ndaj çështjeve pedagogjike, për sa i përket temës së pauperizimit dhe mëshirës shtetërore. Pat mendime liberale të moderuara në politikë dhe ide të zbehte racionale në fushën e fesë. Pas vdekjes së shoqes (1833), iu kthye fesë. Mbas takimit me të bekuarin Antonio Rosmini (1836), mendimi i të cilit iu përgjigjej aspirimit të tij drejt një krishterimit filozofik racional, bëhet përhapës entuziast i filozofisë së tij. Për këtë hyri në polemikë me Vincenzo Gioberti. Mbas vdekjes së të birit Augusto në betimin e Goito (30 maj 1848), mbyllet në meditim, duke u izoluar gjithmonë e më tepër. Qe ndër themeluesit e gazetës *Armonia*, brenda secilës pat një funksion ekuilibruer; dha dorëheqjen nga drejtimi në maj 1851, duke qenë se nuk qe dakord me pozicionin antikushtrues të marrë nga Margotti. I zgjedhur nga Dhoma e Deputetëve nga legjislatura e IV deri te VII në radhët e rrymës katolike konservatore. Vlerësues i don Boskos, e inkurajoi dhe mbështeti punën e tij.



kryetar me fuqi në qytet.<sup>125</sup> Ai më thirri në pallatin bashkiak dhe, duke më mbajtur një diskutim mbi marrëzitë që ishin përhapur për hesapin tim, mbylli duke më thënë: “Meshtari im i mirë, merre këshillën time, lëri të lirë ato fundërrina. Ato do t’ju japin vetëm pakënaqësi ju dhe autoriteteve publike. Unë jam i sigurt që të tilla grumbullime janë të rrezikshme, e për këtë arsye nuk janë të lejueshme”.

- Unë, iu përgjigja, nuk tjetër qëllim, zoti markez, që të përmirësoj fatin e atyre bijve të shkretë të popullit. Nuk kërkoj pará por vetëm një vend ku mund ti mbledh. Me këtë mjet shpresoj të uli numrin e discoli, e numrin e atyre që mbushin burgjet.

- Ju gënjen mendja, meshtari im i mirë; po lodheni kot. Unë nuk mund t’ju jap asnjë vend që të miratoj të tilla grumbullime të rrezikshme; dhe ju a mund të kini mjetet për të paguar qiratë dhe të mbuloni shumë shpenzime që do ju shkaktojnë këto fundërrina? Po ju a përsëris edhe një herë që unë nuk mund të lejoj grumbullime të tilla.

- Rezultatet e marra, zoti markez, më sigurojnë që nuk po lodhem kot. Shumë të rinj krejtësisht të braktisur qenë mbledhur, liruar nga rreziqet, iu dhe ndonjë zanat, dhe burgjet nuk qenë më shtëpia e tyre. Mjetet materiale deri tani nuk më kanë munguar, ato janë në duart e Zotit, i ndonjëherë shërbehet prej instrumentesh të varfër për realizuar planin e tij madhështor.

- Kini durim, duhet të më bindeni patjetër, unë nuk mund t’ju lejon të tilla grumbullime.

- Mos e bëni për mua, zoti markez, por bëjeni për të mirën e shumë të rinjve të braktisur, që ndoshta do të bëjnë në fund të keq.

- Heshtni, unë nuk jam këtu për të diskutoj. Kjo është një parregullsi, dhe dua dhe duhet ta ndaloj. A nuk e dini se çdo grumbullim është i ndaluar, në se nuk ka lejen ligjore?

- Grumbullimet e mia nuk kanë qëllime politike: unë mësoj katekizëm këtyre fëmijve të varfër dhe këtë e bëj me lejen e arqipeshkvit.

- Arqipeshkvi a është i informuar për këto gjëra?

- Është plotësisht i informuar, dhe nuk kam bërë kurrë asnjë hap pa lejen e tij.

- Por unë nuk mund ti lejoj këto grumbullime!

- Unë besoj, zoti markez, që nuk doni të më ndaloni të bëj një katekizëm me lejen e arqipeshkvit tim.

- E në se arqipeshkve vendos të ndërpresë këtë ndërmarrje të tuajën qesharake, nuk do të kundërshtoni?

- Në asnjë mënyrë. Kam filluar dhe kam vazhduar deri tani me pëlqimin e superiorit tim kishtar dhe një arsye e thjeshtë e tija do të jem urdhrin e tij.

- Shkoni, do të flas me arqipeshkvin, por mos jeni kryefort ndaj urdhrave të tij, për ndryshe do të më detyronit të përdori masa të rrepta, që unë nuk dua ti përdor.

---

<sup>125</sup> Ndër detyrat dhe fuqitë e Vikarit të qytetit, cf. Juridiksioni, autoriteti dhe atribuomi i Vikarit soprintendente i përgjithshëm i politikës dhe i policisë.

Gjërat erdhën deri në këtë pikë, besova, paspaku për pak kohë, do të më linin në qetësi. Por sa shumë u turbullova kur sa arrita në shtëpi gjeta një letër me anë të cilës vëllezërit Filippi më hiqnin ambientin që unë kisha marrë me qira.

- Djemtë tuaj, më thonin në atë letër, shkelin pa nda livadhin tonë, kanë bërë që të humbin biles edhe rrënjët e barit. Ne jemi të kënaqur t'ju a falim qiranë e skaduar veçse ju duhet të lironi livadhin tonë brenda pesëmbëdhjetë ditësh. Një mundësi më të mirë nuk mund t'ju a japim.

Sa u hap zëri për vështirësitë e shumta shumë miq më thonin që të braktisja këtë ndërmarrje të kotë, e thënë kështu prej tyre. Të tjerët pastaj, duke më parë sopra pensiero dhe gjithmonë i rrethuar nga djemtë, filluan të thonin se unë isha bërë i marrë.

Një ditë teologu Borel, në prani të meshtarit Sebastiano Pacchiotti<sup>126</sup> dhe të tjerëve, filloi të më thonte kështu: “Për tu mos rënë në sy dhe të humbësh çdo gjë është të shpëtosh diçka nga kjo gjë. Ti lëmë të lirë të djemtë që janë, të mbajmë vetëm nja njëzet vetë ato më të vegjlit. Ndërsa vazhdojmë ti bëjmë mësim katekizmit këtyre, Zoti do të na hapë rrugën dhe mundësim për të bërë më shumë”. Atyre iu përgjigja: “Nuk është e nevojshme të presim një mundësi tjetër vendi është i përgatitur, aty është një oborr i gjerë, një shtëpi me shumë fëmijë, porta hyrse, kisha, priftat, seminaristat, çdo gjë nën urdhrin tuaj”.

- Po ku janë këto gjëra? më ndërpreu teologu Borel.

- Unë nuk di t'ju them se ndodhen, por eksitojnë me të vërtetë dhe janë vetëm për ne.

Atëherë teologu Borel, duke qarë me të madhe, “I shkreti don Bosko, thirri, i ka luajtur mendja e kokës”. Më kapi për dore, më puthi dhe u largu me don Pacchiotti, duke më lënë vetëm në dhomë.

## **22. Largimi nga Streha – Të tjera akuza marrie**

Gjërat e shumta që thuheshin për llogari të don Boskos filluan të shqetësojnë markezën Barolo, aq më tepër që kur bashkia e Torinos tregohej kundër projekteve të mia.

Një ditë, pra, erdhi në dhomën time, ajo filloi të më flasë kështu: “Unë jam shumë e kënaqur për kujdesin që bëni për institutet e mia. Ju falënderoj për punë e madhe që keni bërë për të futur në to këngët dhe lavdet e shenjta, këngën e prerë, muzikën, aritmetikën biles dhe sistemin metrik”.

- Nuk e nevojshme të më falënderoni: meshtarët duhet të punojnë për detyrën e tyre, Zoti paguan të gjitha dhe të mos flitet më për këtë.

---

<sup>126</sup> Sebastiano Pacchiotti (1806-1885), kapelan e veprës Barolo së bashku me teologun Borel dhe me don Boscon; bashkëpunoi aktivisht me Oratorin në katekizëm, rrëfime, predikime dhe në mësimdhënie në shkollat festive dhe të mbrëmjes.

- Doja të thoja, që më vjen shumë keq që të gjithë këto punë kanë shkatërruar shëndetin tënd. Nuk është e mundur që të vazhdoni drejtimin e veprave të mia dhe atë të djemve të braktisur, gjithnjë e më shumë e pranishme, sa që numri i tyre rritet jashtë çdo mase. Unë ju propozoj që të bëni vetëm atë punë që është detyrimi juaj, pra drejtimin e Spitalit të Vogël, të mos shkosh më nëpër burgje, në Cottolengo dhe ndërpritni çdo përkujdesje për të vegjlit. Çfarë mendoni?

- Zonja markeze, Zoti deri tani më ka ndihmuar dhe do të vazhdojë të më ndihmojë. Mos u shqetësoni për punën. Ndërmjet meje, don Pacchiotti, teologut Borel do të kryejmë çdo gjë.

- Por unë nuk të toleroj më që ju të vrisni veten.<sup>127</sup> Janë kaq të shumta punët nga dëshira o jo dëshira kthehen në dëm të shëndetit tënd dhe të qendrave të mia. E pastaj, dhe zërat që dëgjohen rreth shëndetit tënd mendor; kundërshtitë e autoriteteve vendore më detyrojnë t'ju këshilloj.....

- Çfarë, zonja markeze?

- O të lini veprën e djemve, o veprën e Strehës. Mendoni e mu përgjigjeni.

- Përgjigjen time e kam menduar. Ju keni pará e me lehtësi do të gjeni prifta sa të doni për veprat tuaja. Për fëmijët e shkretë nuk është kështu. Në këtë moment në se unë tërhiqem, çdo gjë shkon kot, për këtë arsye unë do të vazhdoj të bëj gjithashtu atë që të mundem për Strehën, do të lë detyrën e zakonshme dhe do të merrem veçanërisht me kujdesin e fëmijve të braktisur.

- Por si mund të jetoni?

- Zoti më ka ndihmuar gjithmonë dhe do të ndihmojë edhe në të ardhmen.

- Por ju keni një shëndet të shkatërruar, koka juaj ju shërben më; do të mbytesh në borxhe; do të vish tek unë, dhe unë po ju them që tani se nuk do t'ju jap kurrë asnjë lek për djemtë tuaj. Tani prano këshillën time si nënë. Unë do të vazhdoj t'ju jap rrogën, edhe më shumë në se do.<sup>128</sup> Ju shkoni të kaloni një, tre, pesë vite në ndonjë vend, pushoni, kur ta keni marrë veten, kthehuni në Strehë dhe do të jesh gjithmonë i mirë pritur. Përndryshe më vini në situatë detyruese të pakëndshme që t'ju pushoj nga puna në veprat e mia. Mendoni seriozisht.

- Këtë e kam menduar, zonja markeze. Jetën time ia kam kushtuar së mirës së rinisë. Ju falënderoj për propozimet që më bëtë, por nuk mund të largohem nga rruga që Provania hyjnore më ka planifikuar.

- Pra preferon vagabondët tuaj në vend të instituteve të mia? Në se është kështu, je i pushuar në çast. Që sot do të sigurohem se kush do të zëvendësojë.

I thashë që të shikonte se një paralajmërim kaq me nxitim do të kishte bërë të mendoheshin arsye jo të ndershme as për mua as për të: ishte më mirë të veprime me qetësi, dhe të ruanim mes nesh atë bamirësi, me të cilën duhet të flasim të dy në gjyqin e Zotit.

<sup>127</sup> Arset e markezës Barolo janë të përshkruara në një letër të teologur Borel, me 18 maj 1846.

<sup>128</sup> Sipas G.B.Lemoyne paga e marrë nga don Bosko si kapelan i Spitalit të Vogël ishte 600 lire vjetore.

- Pra, përmbylli, ju jap tre muaj, pastaj do ti lë të tjerët të drejtojnë Spitalin tim të vogël.

Pranova paralajmërimin, duke u lëshuar i tyri në atë që Zoti do të kishte përcaktuar për mua.

Ndërkohë mbizotëronte më shumë zëri se don Bosko ishte bërë i marrë. Miqtë e mi tregoheshin të dhimbshëm; don CAFasso këshillonte të zvarritej koha, teologu Borel heshte. Kështu të gjithë bashkëpunëtorët e mi më lanë vetëm në mes të katërqind fëmijësh.

Në këtë rast disa persona të respektuar dëshironin që të kisha kujdes për shëndetin tim. “Ky don Bosko-ja, thonte njëri prej tyre, ka disa fiksime që do ta çojnë në mënyrë të pashmangshme në çmenduri. Ndoshta një mjekim i bën mirë. Ta dërgojmë në çmendi dhe atje, me kujdesin e duhur, do të bëjë se çfarë urtësia do ta kshillojë”. Iu ngarkua dy vetëve që të vinin të më merrnin me në karrocë dhe të çonin në çmenduri. Të dy më përshëndetën me mirësjellje, pastaj më kërkuan lajme mbi shëndetin tim, të Oratorit, për të ardhmen e ndërtesës dhe të kishës, në fund nxorën në ofshamë të thellë dhe mbyllën me këto fjalë: “Është e vërtetë”. Pastaj më ftuan të bëj një shëtitje së bashku me to. “Pak ajër i pastër do të të bëjë mirë; eja; biles kemi edhe karrocën, shkojmë së bashku dhe kemi kohë për të diskutuar”.

Atëherë më ra në sy loja që donin të më bënin, dhe pa u treguar mendjehollë, i shoqërova tek karroca, ngula këmbë që ato të hynin të parët dhe të zinin vend në karrocë, në vend që të hyja edhe unë, i mbylla sportelin me ngut dhe i thashë karrocierit: “Shkoni me të shpejtë në çmenduri, ku këto dy klerikë po i presin”.

### **23. Transferimi i Oratorit aktual të Shën Frasçeskut të Sales në Valdocco**

Ndërsa po ndodhnin gjërat e sipërpërmendura, kishte arritur e diela e fundit, në të cilën më lejohej akoma të mbaj Oratorin në livadh (15 mars 1846).<sup>129</sup> Unë heshtja për çdo gjë, por të gjithë kishin marrë vesh për shqetësimet dhe hallet e mia. Afër mbrëmjes së asaj dite shihja atë mori fëmijësh, që lonin; dhe mendoja për të messe të bollshme që po përgatitej për shërbimin e shenjtë, në të cilën ishin vetëm punëtorë, të këputur nga lodhja, me një shëndet të shkatërruar, pa ditur se ku do ti mblidhja në të ardhmen djemtë e mi. U ndjeva krejt i përmalluar.

Ndërsa ndodhesha mënjanë, fillova të eci i vetëm, dhe ndoshta për herë të parë, u ndjeva i përmalluar sa më dolën edhe lot. Duke ecur dhe duke çuar sytë nga qielli, “Zoti im, thirra, përse nuk ma bëni të dukshëm vendin në të cilin doni që unë të mbledh këto fëmijë? O ma bëni të ditur ose më tregoni se çfarë duhet të bëj”.

---

<sup>129</sup> Ngjarja që përshkruhet ka ndodhur, me shumë mundësi, një të diele përpara, me 8 mars, siç tregon një letër e don Boskos Vikarit të qytetit, me datën 13 mars 1846.

Sapo mbarova shprehjen, kur arriti një person, quhej *Pancrazio Soave*<sup>130</sup> që duke iu marrë goja më thotë: “A është e vërtetë që kërkon një vend për të bërë një laborator?”.

- Jo një laborator, por një Orator.

- Nuk e di se a është e njëjta gjë Orator o laborator, por një vend është, eja e shihe. Është nën pronësinë e zoti Giuseppe Pinardi,<sup>131</sup> një burrë i ndershëm. Eja se do të bësh një kontratë të mirë.

Si me porosi erdhi në atë çast një shok besnik, koleg i seminarit, don Pietro Merla, themelues i veprës fetare e njohur me emrin *Familja e Shën Pjetrit*.<sup>132</sup> Ai merrej me shumë zell me shërbimet shenjte, dhe kishte filluar këtë institut për të parandaluar braktisjen në të cilën gjindeshin vajzat e pamartuara ose gratë që kanë pasur fatkeqësi, që, mbasi kishin kryer dënimin në burg, për më tepër të urryera nga shoqëria e të ndershëmve, që për to ishte pothuajse e pamundur të gjenin dikë që ti jepte bukë o punë. Kur këtij meshtari të denjë i tepronte pak kohë, vraponte me kënaqësi në ndihmë të mikut të tij, që për më tepër ndodhje i vetëm në mes të një morie djemsh.

- Çfarë ke, më tha sapo më pa, nuk të kam parë kurrë kaq të trishtuar. Të ka ndodhur ndonjë fatkeqësi?

- Fatkeqësi jo, por një siklet i madh. Sot është dita e fundit, që më lejohet të qëndroj në livadh. Tashti është mbrëmje; ka vetëm dy orë ditë, duhet ti them djemve të mi se ku duhet të mblidhemi të dielën tjetër dhe nuk e di. Erdhi këtu një mik, që më tha është një vend që mund të jetë i përshtatshëm. Eja, shoqëro një çast pushimin; unë po shkoj të shoh dhe shpejt do të kthehem.

Kur arrita në vendin e caktuar, pashë një kasolle një kati me një shkallë dhe ballkon druri të ngrënë nga teja, i rrethuar nga kopshte, livadhe, fusha. Unë doja të ngjitesha në shkallë, për Pinardi dhe Pancrazio, “Jo, më thanë. Vendi i caktuar për ty është këtu mbrapa”. Ishte një mbulojë e gjatë, që nga njëra anë mbështetje në mur, dhe nga ana tjetër përfundonte një metër lart nga toka. Për nevojë mund të shërbente si magazinë o për dru dhe për diçka tjetër. Për të hyrë brenda mu desh të përkulja kokë për të mos hasur me tavan.<sup>133</sup>

- Nuk më shërben, sepse është shumë e ulët, i thashë.

---

<sup>130</sup> Pancrazio Soave: tregtar me origjinë nga Verolengo (komunë rreth 34 km nga Torino) që, nga 10 nëntori 1845, kishte lëshuar me qira shtëpinë Pinardi.

<sup>131</sup> Duhej të ishte Francesco Pinardi. Pinardi, i emigruar në Torino tek Arcisate (Varese), që në atë kohë bënte pjesë në Mbretërinë Lombarde-Veneta, kishte blerë shtëpinë “me 14 korrik 1845, nga vëllezërit Giovanni e Carlo Filippi për shumën prej 14 mijë liresh [.....]; me 10 nëntor të të njëjtit vit mbaronte qiraja e zotit Pancrazio Soave”, me përjashtim të mbulesës që po ndërtohej mbas shtëpisë, por jo terreni që ishte përpara saj.

<sup>132</sup> Pietro Merla (1815-1855), shok i seminarit i don Boskos dhe shok i madh i tij; në atë vit ishte kapelan i burgjeve femërore. Dy vjet më vonë do të themelonte *Terheqja e Shën Pjetrit Apustull* (e quajtur ndryshe *Familja e Shën Pjetrit*) i destinuar për të pritur gra të dala nga brgjet dhe përfshirjen e tyre në shoqëri.

<sup>133</sup> Si del nga kontrata e qirasë ndërmjet Pinardit e Soave, mbuloja që ndërtuar në nëntor të 1845.

- Unë do të ndreq si të duash, vazhdoi hijshëm Pinardi. Do të gërmoj, do të bëj shkallë, do të bëj tjetër dysHEME; por dëshiroj shumë që laboratorin yt të stabilizohet këtu.

- Nuk është një laborator, por një Orator, një kishë e vogël për të mbledhur të rinjtë.

- Edhe më mirë akoma. Do ti bëj më shumë dëshirë. Të bëjmë kontratën. Sam edhe unë këngëtar, do të vij të ndihmoj; do të sjell dy karrige, një për mua një për time shoqe. E pastaj në shtëpinë time kam lampana, do ta sjell këtu.

Ai njeri duke se vaneggiase nga kënaqësia që të kishte një kishë në shtëpinë e tij.

- Ju falënderoj, o mik i mirë, nga mëshira jote dhe dëshira jote e mirë. Pranoj këtë ofertë. Në se mundesh të më ulësh dysHEMENË jo më pak se 50 cm, unë pranoj, por sa ma jepni?

- Treqind franka; donin të më jepnin më shumë, por unë të preferoj ju, që do t'ia kushtosh këtë vend në dobi të një publiku dhe të fesë.

- Ju jap treqindnjëzet, veçse të më jepni edhe atë rrip toke që e rrethon për pushimin e të rinjve; por ama të më premtosh që të dielën e ardhshme të mund të vij këtu me djemtë e mi.

- Dakord, marrëveshje e mbyllur. Eja patjetër. Çdo gjë do të ketë kryer.<sup>134</sup>

Nuk kërkova më. Vrapove shpejt për të djemtë e mi; i mblodha rreth meje dhe me zë të lartë fillova të bërtas: "Guxim, djemtë e mi, kemi në Orator më të qëndrueshëm se në të shkuarën; do të kemi kishën, sakristinë, dhomat për shkollën, vendin për lojrat. Të dielën, të dielën do të shkojmë në Oratorin e ri që do të jetë në shtëpinë Pinardi". Dhe atyre i tregova me gisht vendin.

Ato fjalë qenë të pritura me shumë entuziazëm të gjallë. Kush vraponte o hidhej nga gëzimi; kush rrinte i pa lëvizur; kush bërtiste me zë biles me të thirrura e klithma. Por të përmalluar si dikush që provon një kënaqësi dhe nuk di si ta shpreh, të transportuar nga mirënjohja më e thellë dhe për të falënderuar të Shenjtën Virgjineshë që kishte miratuar dhe plotësuar lutjet tona, që pikërisht atë mëngjes kishim bërë tek Madonna di Campagna, u ulëm në gjuhë për të fundit herë në atë livadh, dhe filluam të thonin të shenjte Ruzare pastaj gjithsecili u nis për në shtëpinë e tij. Kështu iu dha përshëndetja e fundit atij vend, që secili e kishte dashur për nevojë, por që, me shpresën që do të kishim një më të mirë, braktisej pa keqardhje.

Të dielën që erdh, solemnitetin e Pashkës, me datën 12 prill, transportuam atje të gjitha mjetet e lojrave, dhe shkuam të merrnim në zotërim vendin e ri.<sup>135</sup>

<sup>134</sup> Kontata e qirasë, ka datën 1 prill 1846 dhe e firmosur nga Francesco Pinardi dhe nga teologu Giovanni Borel, parashikonte një pagesë qirare prej 300 lire në vit.

<sup>135</sup> Të shihet letra e 13 marsi të 1846, me anë të cilës don Bosko informon Vikarin e qytetit mbi të rejat e Oratorit.